



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 49/2024 regjistër (JR)
Datë 10.12.2024

Nr. 89 vendimit
Datë 09.12.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Ina Rama	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Rezarta Schuetz	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 09.12.2025, ditën e martë, në orën 14:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Cardi, me sekretare gjyqësore Griselda Muça, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit Dashnor Nure, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 793, datë 04.09.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 179/b, paragrafi 5, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës;
Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shqyrtoi pretendimet e kërkesave të subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 793, datë 04.09.2024 dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes, Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Dashnor Nure (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex-officio*, për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”).
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka zhvilluar hetimin administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit, përkatësisht për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Në zbatim të përcaktimeve të neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016, nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar¹ (në vijim “AKSIK”), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), sipas neneve 40 - 44 të po këtij ligji.

2.1. ILDKPKI-ja, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për pasurisë, i ka dërguar Komisionit raport kontrollin², në të cilin konkludohet se: *Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja, për subjektin e rivlerësimit, z. Dashnor Nure konstaton se:*

- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.;

2.2. AKSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me qëllim identifikimin nëse ai ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e

¹ Ish-Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK).

² Me shkresën nr. {***} prot., datë 21.12.2017.

rivlerësimit, AKSIK-ja ka dërguar në Komision dy raporte³. Sipas raportit të parë, me nr. {***} prot., datë 02.11.2017, subjekti i rivlerësimit Dashnor E. Nure klasifikohet i përshtatshëm për vijimin e detyrës. Nisur nga kërkesa e Komisionit për deklasifikimin e këtij raporti, AKSIK-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 02.07.2024, ka dërguar raportin e dytë mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Dashnor E. Nure të deklasifikuar pjesërisht, në të cilin pasqyrohet se: *“Informacionet e ardhura nga autoritetet verifikuese në kohështrirje mbas periudhës së rivlerësimit, na bëjnë me dije se: Për subjektin e rivlerësimit Dashnor Nure, disponohen të dhëna [...] mbi përfshirjen e tij në veprimtari të kundraligjshme, shfaqur në formën e ndërveprimit korruptiv. [...]”*. Sa më sipër, në konfirmim të konstatimit fillestar, për përshtatshmërinë e vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit Dashnor E. Nure, gjejkojmë që për rastin në fjalë konkluzioni mbetet në vlerësimin tuaj nën dritën e informacioneve të tjera që mund të dispononi si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedura e hetimit administrativ që po kryhet ndaj subjektit të rivlerësimit.

2.3. KLP-ja, për subjektin e rivlerësimit, ka hartuar raportin⁴ për analizimin e aftësive profesionale, të cilin ia ka përcjellë Komisionit.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Me vendimin nr. 793, datë 04.09.2024, Komisioni ka vendosur: *“Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Dashnor Nure, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë”*.
4. Vendimmarrja e Komisionit për subjektin e rivlerësimit është bazuar në përfundimet e arritura në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, si dhe në vlerësimin tërësor të rrethanave dhe procedurave, sipas parashikimit të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, të cilat kanë pasjellë aplikimin e nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, duke analizuar dhe konkluduar në vendim se:

4.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë dhe është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë e tij. Sipas vlerësimit të trupit gjykues, referuar kuadrit kushtetues dhe ligjor të zbatueshëm për vlerësimin e kriterit të pasurisë, rrethanat e konstatuara në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, bazuar në konkluzionet e arritura më lart, çojnë në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Dashnor Nure nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë

4.2. Për kriterin e kontrollit të figurës:

Komisioni, pas hetimit të kryer për këtë kriter, bazuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në vlerësim të raportit të figurës, rezultateve të hetimit lidhur me çështjet e referuara më lart, si dhe në kuadër të çmuarjes së shpjegimeve që ka dhënë edhe subjekti, krijoi bindjen se informacionet që disponoheshin në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Dashnor Nure, sipas kërkesave të

³ Raporti fillestar me shkresën nr. {***} prot., datë 02.11.2017. Raporti vijues me shkresën nr. {***} prot., datë 02.07.2024, i deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {***}, datë 03.07.2024, të AKSIK-së.

⁴ Me nr. {***} prot., datë 22.06.2023.

shkronjave “b” dhe “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, ishin të bazuara në fakte dhe rrethana konkrete.

Në këndvështrimin e përgjithshëm, edhe nëse ky konkluzion nuk do të ishte i mjaftueshëm për të arritur në një konkluzion lidhur me kontrollin e pastërtisë së figurës së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se mospërbushja e rregullt e detyrës cenon pastërtinë e figurës së subjektit dhe shkallën e besueshmërisë së subjektit të rivlerësimit Dashnor Nure, në zbatim të pikës 2 të nenit 4 dhe pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

4.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:

Trupi gjykues, bazuar në konstatimet e mësipërme, argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe bazuar në kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pas një analize në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkludon se në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësisë profesionale.

4.4. Për vlerësimin tërësor:

Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, sipas së cilave ai nuk ka vepruar në përputhje me nenin 24/1 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe mbi mungesën e kryerjes së veprime hetimore prej tij nga data 18.02.2015 deri më 18.05.2015. Komisioni, pasi administroi dhe vlerësoi shpjegimet e subjektit, mban qëndrimin se subjekti ka treguar mangësi në përmbushjen e rregullt të detyrës, duke cenuar shkallën e besueshmërisë së tij në zbatim të pikës 2 të nenit 4 dhe pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

III. Ankimi kundër vendimit të Komisionit

5. Kundër vendimit të Komisionit nr. 793, datë 04.09.2024, ka paraqitur ankim subjekti i rivlerësimit Dashnor Nure. Nga analizimi i përmbajtjes së ankimit, konstatohet se përmban pretendimet e subjektit për cenim të procesit të rregullt ligjor, si dhe pretendime që kundërshtojnë konkluzionet e Komisionit për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe çështjet penale të analizuara në kuadër të kontrollit të figurës dhe aftësive profesionale.

A. Shkaqe ankimi që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

6. Analiza financiare e kryer nga Komisioni për automjetin tip “Mercedes-Benz 250D”, të blerë në vitin 2004 është e pasaktë dhe e gabuar për shkak se:
 - i) Komisioni në analizën e tij në mënyrë të gabuar ka përfshirë si vlerë të blerjes së automjetit një shumë më të lartë se ajo e përcaktuar në kontratën noteriale të shitblerjes së tij.
 - ii) Komisioni nuk ka konsideruar si pjesë të të ardhurave të vitit 2004, shumën prej 250.000 lekësh të siguruar në të njëjtin vit nga shitja e automjetit tjetër.
 - iii) Analiza për këtë automjet është kryer se bashku me analizën e kursimeve në *cash* të deklaruar si të disponuara në vitin 2004, kur ndërkohë duhet të ishte ndalur deri në ditën e blerjes së automjetit.
7. Lidhur me likuiditetet në *cash* në vlerën 650.000 lekë, të deklaruar në deklaratën *vetting* dhe shumën 900.000 lekë të deklaruar si kursime *cash* në DVP-në 2004, pretendon se analiza e

kryer nga Komisioni është jo e saktë për shkak të aplikimit të një metodologjie të gabuar, e cila ka të bëjë me:

- i) periudhën gjatë së cilës është konsideruar se është krijuar gjendja *cash* e deklaruar në deklaratën *vetting*;
 - ii) moskonsiderimin e shpjegimit të subjektit se gjendja *cash* në shumën 900.000 lekë e deklaruar në DVP-2004, i përket gjendjes *cash* të disponuar prej tij në fund të marsit 2005, me burim krijimi kryesisht kredinë e disbursuar në dhjetor të vitit 2004, e cila është tërhequr prej tij në janar 2005;
 - iii) përdorimin e kursimeve *cash* të deklaruara si gjendje në deklaratën fillestare të deklarimit të pasurisë të vitit 2004.
8. Subjekti i rivlerësimit pretendon se analiza e Komisionit për adresat e tij të banimit, përfshirë shtëpinë e vëllezërve, për të cilat ka konkluduar se ai ka bërë deklarime të pasakta dhe kontradiktore, duke e vendosur këtë organ në kushtet e pamundësisë objektive për të kontrolluar pasurinë, është produkt i kësaj analize hamendësuese, e cila nuk përkon me realitetin dhe nuk është e bazuar në fakte dhe prova.

B. Shkaqe ankimi që lidhen me kriterin e kontrollit të figurës dhe të cenimin e besimit të publikut

9. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit objekt shqyrtimi nuk ka analizuar dhe argumentuar se përse gjejnë trajtim në kriterin e kontrollit të figurës:
- i) çështje që kanë të bëjnë me kriterin e vlerësimit profesional;
 - ii) kundërshton si të paargumentuar dhe të pabazuar ligjërisht konkluzionin e Komisionit, lidhur me dosjen penale nr. {***/2014 të regjistruar për veprën penale “Prerje të paligjshme të pyjeve” të parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal;
 - iii) kundërshton si të pabazuara dhe të paargumentuara konkluzionet për shkeljet e pretenduara si të kryera nga subjekti në lidhje me çështjen e shtetasit G.Gj., duke pretenduar se: (a) nuk ka qenë detyrë e tij funksionale ndarja e çështjeve nëpërmjet shortit elektronik dhe, për pasojë, nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për këtë çështje; (b) në trajtimin e bërë për çështjen penale të shtetasit G.Gj., Komisioni nuk ka konsideruar qëndrimin e subjektit para gjykatës, i cili ka qenë kundër pranimin të kërkesës së këtij të dënuari për “lirim me kusht”.
10. Subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzionet e Komisionit, lidhur me denoncimin e shtetasës Xh. Q., që lidhet me procedimin penal nr. {***/2014 ndaj shtetasit Gj. N., për veprën penale “Mjekim i pakujdesshëm”, të parashikuar nga neni 96 i Kodit Penal, janë të paargumentuara të pabazuara ligjërisht.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

a) Juridiksioni i Kolegjit

11. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) për gjykimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me procesin e rivlerësimit të subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç

rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit 5, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, që ka vendosur për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Dashnor Nure, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

12. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma e gjykimit

13. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si rregull, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankohet nga subjekti i rivlerësimit, kryhet në dhomë këshillimi. Subjekti i rivlerësimit Dashnor Nure ka kërkuar në ankim që çështja e tij të gjykohej në seancë gjyqësore publike, me qëllim *shqyrtimin në themel të fakteve dhe provave*, duke vendosur: *Ndryshimin e vendimit nr. 793 vendimi, datë 04.09.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Dashnor Nure, në funksionin prokuror në Prokurorisë pranë Gjykatë së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.*

13.1. Në ankim, subjekti i rivlerësimit ngre shkaqe procedurale duke pretenduar se: (i) procesi i tij i rivlerësimit në Komision ka qenë i paragjykuar në tërësinë e tij, pasi provat e administruara gjatë hetimit nuk mbështesin vendimmarrjen për shkarkimin e tij nga detyra, pasi asnjë nga provat e administruara nuk tregojnë se subjekti kishte pasuri të fshehur, nuk kishte burime të ligjshme të krijimit të pasurisë, si dhe kishte bërë deklaratime të rreme apo kishte më shumë se 2-fishi i pasurisë së ligjshme; (ii) rezultatet e hetimit nuk tregojnë se subjekti kishte kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (iii) Komisioni ka shkelur një nga të drejtat themelore të subjektit që është e drejta për t'u dëgjuar; (iv) Komisioni ka shkelur parimin e paanshmërisë; (v) Komisioni nuk ka konsideruar jurisprudencën e Kolegjit, duke cenuar parimin e barazisë para ligjit; (vi) Komisioni ka përdorur logjikë të gabuar ligjore dhe ekonomike.

13.2. Trupi gjykues konstaton se ndonëse subjekti ngre këto pretendime rezulton se prej tij mungon identifikimi i elementëve konkretë të veprimtarisë së Komisionit, të cilat evidentojnë cenimin e të drejtave procedurale të subjektit, rrethanë e cila pamundëson kryerjen e një analize rreth tyre, përveç se në një vlerësim të përgjithshëm, konstatohet se këto pretendime nuk qëndrojnë.

13.3. Po ashtu, konstatohet se pretendimet e subjektit *se provat e administruara nuk mbështetin vendimmarrjen e Komisionit, si dhe pretendimi se ky organ ka përdorur një logjikë të gabuar ligjore dhe ekonomike*, janë çështje që janë ringritur dhe integruar nga subjekti, në pretendimet lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, dhe janë analizuar si të tilla në pjesën vijuese të këtij vendimi. Në referim të sa më sipër, nuk identifikohen elementë të cilët evidentojnë shkelje të

parimeve të procesit të rregullt ligjor të cilat duhet të korrighohen gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj nëpërmjet zhvillimit të gjykimit në seancë gjyqësore publike. Në të njëjtën logjikë, trupi gjykues konstaton se nuk identifikohen çështje që lidhen me situatën faktike, për të cilat nevojitet debati gjyqësor, pasi ajo konsiderohet e pasqyruar plotësisht në vendimin e Komisionit.

13.4. Në përfundim, trupi gjykues, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit me ankimin nuk ka paraqitur prova të reja përtej atyre të paraqitura në Komision, si dhe nuk konstatohet as një prej situatave të parashikuara nga neni 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 49/2012), që do të diktonte gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, vijoi me shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi mbështetur në dokumentacionin e administruar nga hetimi administrativ në Komision, në përputhje me parashikimin e nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit nga Kolegji

Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

14. Trupi gjykues, fillimisht mori në shqyrtim pretendimin e subjektit të rivlerësimit, *lidhur me analizën financiare të kryer prej Komisionit në funksion të kontrollit të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e së vetmes pasuri të deklaruar prej tij në deklaratën vetting, automjetin “Mercedes Benz 250D”, të blerë në vitin 2004.*

14.1. Në vendimin e Komisionit, lidhur me automjetin tip “Mercedes-Benz” 250D, duke konsideruar si shpenzim për blerjen e tij jo çmimin e vendosur në kontratën e shitblerjes prej 400.000 lekësh, por atë të vendosur në kontratën e blerjes së këtij mjete nga shitësi në shumën prej 5.300 eurosh, përfshirë edhe detyrimet e taksës doganore në vlerën totale prej 894.578 lekësh, është kryer analiza financiare për të kontrolluar mundësitë e subjektit për financimin e tij me burime të ligjshme, prej nga ka rezultuar se ai ka qenë në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për financimin e kësaj pasurie në vitin 2004, krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar në fund të vitit dhe përballimin e shpenzimeve të jetesë, për një vlerë prej (-) 656.698 lekësh. Për shkak të këtij rezultati, Komisioni ka konkluduar se *veprimet e subjektit për të deformuar të vërtetën lidhur me këtë pasuri përfaqësojnë përpjekjet e tij për të justifikuar mungesë burimesh të ligjshme dhe se këto veprime rezultojnë të shoqëruara me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pagimin e pasurisë, duke e vendosur subjektin në kushtet e parashikimeve të nenit 33, pika 5 dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, të analizuar edhe me parashikimin në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.*

14.2. Trupi gjykues, në funksion të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit lidhur me këtë pasuri, mori në analizë deklaratimet e bëra për të nga subjekti në deklaratën *vetting*, në deklaratimet vjetore periodike (në vijim “DVP”), si edhe të dhënat që rezultojnë nga aktet e administruara në hetim nga Komisioni, nga të cilat rezulton se:

- i) Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar pasurinë: *Autoveturë Mercedes-Benz {***}, e blerë më datë 28.11.2004, kam paguar detyrimet doganore. Burimi i krijimit nga të ardhurat e mia personale nga pagat. Vlera: 404.923 lekë.*
- ii) Në DVP-në 2004, te rubrika e deklaratimit të pasurive, subjekti ka deklaruar: *Autoveturë Mercedes-Benz 250D, vlera 400.000 lekë - 180.000 lekë vlera e blerës + 220.000 lekë vlera*

*e zhdoganimit. Blerë me kontratën noteriale nr. {***} rep., e {***} kol., datë 23.11.2004; te rubrika e deklarimit të të ardhurave: Të ardhura të krijuara nga shitja e autoveturës Benz me kontratë shitje noteriale më datë 21.10.2004, vlera 250.000 lekë.*

- iii) Nga kontrata e shitblerjes së automjetit, me të cilin subjekti ka fituar pronësinë mbi të, nga shitësi Sh. K., rezulton se çmimi i blerjes është 180.000 lekë dhe shpenzimet doganore rezultojnë të jenë paguar në vlerën prej 224.923 lekësh.
- iv) Sipas dokumentacionit marrë nga Regjistri Publik Automobilistik {***} ({***}), lëshuar më datë 02.03.2004 nga Drejtoria e Zyrave të KAI, në shtetin italian, z. Sh. K. ka blerë automjetin në datën 14 tetor 2004, në shumën 5.300 euro, si edhe janë paguar detyrimet doganore në shumën 224.923 lekë.

14.3. Trupi gjykues, mbështetur në të dhënat e cituara më lart, si edhe në shpjegimet e dhëna prej subjektit në hetim dhe ankim, mori në shqyrtim pretendimin e tij se *Komisioni në analizën e tij në mënyrë të gabuar e të padrejtë ka përfshirë si vlerë të blerjes se automjetit një shumë më të larë se ajo e përcaktuar në kontratën noteriale të shitblerjes së tij, duke analizuar e vlerësuar si vijon.*

14.3.1. Siç u evidentua më sipër, nga të dhënat që rezultojnë nga hetimi, subjekti ka deklaruar si vlerë të shpenzuar për blerjen e këtij automjeti shumën prej 400.000 lekësh, në deklaratën *vetting*, por edhe në DPV-në 2004, si dhe ka mbajtur të njëjtin qëndrim për këtë shumë të shpenzuar edhe në përgjigje të pyetjeve të shtruara nga Komisioni për shpjegimin e mospërputhjes mes kësaj vlere dhe asaj që rezulton të jetë shpenzuar prej shitësit, për blerjen e tij, përreth një muaj më parë se pronësia të fitohet nga subjekti. Subjekti ka shpjeguar në Komisioni se: *Nuk kam pasur dijeni për vlerën me të cilën ishte shitur automjeti. Nuk e dija nëse kishte mospërputhje ndërmjet çmimit të blerjes dhe çmimit të shitjes. Megjithatë në një marrëdhënie të tillë që lidhet me shitblerjen nuk është e thënë që çmimi i shitjes dhe i blerjes të kenë përputhje, ato ndryshojnë në varësi të gjendjes së sendit në kohën e shitjes dhe vullnetit të palëve për të caktuar çmimin e shitjes. Unë, siç kam shpjeguar, kam pranuar ofertën si të arsyeshme dhe të përbalueshme nga ana ime. Theksoj se unë vetë kam paguar edhe detyrimin doganor, dhe vlera e automjetit ka rezultuar më e lartë se vlera e caktuar në kontratën e shitblerjes.*

14.3.2. Nga sa më sipër, duket se subjekti nuk ka dhënë shpjegime bindëse apo të arsyeshme mbi diferencën e vlerave të shpenzuara për blerjen e automjetit prej shitësit e më pas prej atij vetë, duke mos i dhënë asnjë kuptim logjik këtij transaksioni. Nuk referohet asnjë e dhënë që do të mund të justifikonte faktin që shitësi, pasi ka blerë automjetin për vlerën prej 5.300 eurosh, pas një muaji ta shesë atë me humbje në vlerën prej 180.000 lekësh.

14.3.3. Përveç mungesës së arsyeve bindëse, trupi gjykues konstaton se në një pikë të hetimit administrativ, duket se subjekti është pajtuar me llogaritjen nga Komisioni, si vlerë të shpenzuar për blerjen e kësaj pasurie, atë të llogaritur mbi shumën e shpenzuar në total prej 894.578 lekësh, si dhe ka ndërtuar pretendime të tij alternative edhe mbi këtë version të analizës. Po ashtu, rezulton se edhe në seancën dëgjimore të zhvilluar në Komision, subjekti, pasi është njohur me qëndrimin e Komisionit, që referon përfshirjen në analizë si çmim të

automjetit vlerën prej 5.300 eurosh⁵, nuk ka dhënë shpjegime për të kundërshtuar përfshirjen e kësaj shume në analizën e vitit 2004. Konstatohet, gjithashtu, se subjekti, në ankim, ka pretenduar *se edhe në raste se vlera e blerjes së automjetit në vitin 2004 konsiderohet në shumën 5.300 euro, ai sërish ka pasur mundësi për të financuar me të ardhura të ligjshme blerjen e tij*, duke mosartikulluar kundërshti konkrete rreth këtij qëndrimi të Komisionit.

14.3.4. Nisur nga këto të dhëna, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit për të përfshirë në analizë si vlerë të blerjes së automjetit shumën 180.000 lekë, e cila është përcaktuar në kontratën e shitblerjes së tij, është jo vetëm i një pretendim i articular qartësisht vetëm me ankimin, por rezulton të jetë edhe i pabazuar, për sa kohë që subjekti nuk ka arritur të rrëzojë konkluzionin e Komisionit se në fakt vlera reale e shpenzuar për fitimin e pronësisë mbi të është ajo që llogaritet mbi vlerën prej 5.300 eurosh të shpenzuar prej shitësit të saj. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se analizën financiare të kryer për kontrollin e burimeve të ligjshme për financimin e kësaj pasurie, me të drejtë është llogaritur si çmim blerje vlera prej 5.300 eurosh.

14.3.5. Për sa i përket konkluzionit të Komisionit se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën *vetting*, lidhur me çmimin e blerjes së kësaj pasurie, trupi gjykues vlerëson se deklarimi në këtë deklaratë i çmimit të caktuar në kontratën e shitjes së pasurisë nuk e vendos subjektin në kushtet e një deklarimi të pasaktë, sipas leximit *a contrario* të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *vetting* atë vlerë që përmban dokumentacioni ligjor shoqërues dhe, në këtë kuptim, deklarimi i tij nuk mund të konsiderohet i pasaktë. Përndryshe, trupi gjykues vlerësoi se subjekti nuk arriti të provojë bindshëm se ky çmim është pikërisht ai i negociuar dhe paguar prej tij për fitimin e pasurisë, konsideruar rrethanat e përshkruara më lart. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni që lidhet me këtë çështje, me pasojë për vlerësimin e kësaj pasurie, është vetëm ai që përcakton si vlerë në analizën financiare atë që i referohet çmimit prej 5.300 eurosh dhe jo çmimit prej 180.000 lekësh të deklaruar nga subjekti.

14.4. Në vijim, trupi gjykues mori në analizë pretendimin e subjektit të rivlerësimit *se në mënyrë të gabuar dhe të padrejtë Komisioni nuk ka përfshirë si pjesë e të ardhurave në analizën financiare të vitit 2004, shumën prej 250.000 lekësh të siguruar nga shitja me kontratë noteriale e automjetit që dispononte më parë subjekti*, për të cilin vlerëson sa vijon.

14.4.1. Në aktin “Rezultatet e hetimit administrativ”, konstatohet se Komisioni, në analizën financiare të kryer për të kontrolluar burimet e ligjshme për financimin e pasurisë automjet, nuk ka përfshirë si të ardhur të përfituar në vitin 2004 shumën 250.000 lekë, që subjekti ka siguruar nga shitja e një automjeti në pronësi të tij, në tetor të këtij viti, para blerjes së automjetit tip “Mercedes-Benz” me targë {***}. Në vendim, Komisioni arsyeton se mospërfshirja e kësaj shume si burim i blerjes së automjetit objekt kontrolli, është bërë për shkak se ai nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting* e as në DVP-në 2004, përdorimin e saj si burim financimi për automjetin e ri.

14.4.2. Komisioni ka pranuar në vendim se subjekti ka blerë një automjet me anë të kontratës së shitjes, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.02.2003, me palë shitëse F. F. dhe blerës

⁵ Vlera 5.300 euro korrespondon me vlerën me të cilën ky automjet është blerë nga shitësi në Itali, pasi kjo vlerë është konsideruar si reale, meqenëse në kontratën e shitblerjes nuk ka as pretendime/përcaktime për gjendjen teknike të mjetit.

Dashnor Nure, në vlerën 250.000 lekë. Gjithashtu, Komisioni ka pranuar se me kontratë shitjeje automjeti nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.10.2004, me palë shitëse Dashnor Nure dhe blerës I. S. R., ky automjet është shitur në vlerën 250.000 lekë. Kjo kontratë dhe të ardhurat e përfituara prej saj janë deklaruar nga subjekti në DVP-në 2004, në rubrikën e të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2004. Pavarësisht këtyre të dhënave, Komisioni në analizën financiare nuk e ka përlllogaritur këtë shumë në të mesin e të ardhurave të krijuara nga subjekti deri ditën e blerjes së automjetit objekt kontrolli nën argumentin se kjo e ardhur nuk ishte deklaruar specifikisht si burim i krijimit të pasurisë. Paralelisht me këtë arsyetim, Komisioni ka artikuluar në arsyetimin e vendimit se edhe në versionin që kjo shumë do të konsiderohej si e ardhur që ka shërbyer për financimin e automjetit, sërish subjekti do të rezultonte me një balancë negative për blerjen e tij në vlerën prej (-) 656.698 lekësh.

14.4.3. Trupi gjykues, në analizë të situatës së mësipërme, vlerëson se ndonëse kjo shumë nuk është cituar shprehimisht si një vlerë e përdorur për burimin e krijimit të pasurisë automjet, në kontekstin e analizës financiare që është bërë për njësinë familjare, kjo vlerë duhet të përfshihej në të ardhurat e subjekti, për sa kohë që ishin krijuar përpara se të kryhej blerja e automjetit objekt kontrolli dhe ishin deklaruar si të tilla edhe në DVP-në e vitit 2004. Moskonsiderimi i të ardhurave të realizuara brenda të njëjtin viti financiar, edhe para se të krijohet pasuria nën kontroll, do të deformonte analizën financiare të kryer, duke mospasqyruar në të të ardhura të dokumentuara, që provohet se janë bërë pjesë e ekonomisë së subjektit. Fakti që subjekti ka deklaruar në deklaratën *vetting* se ka blerë automjetin me të ardhurat nga puna, nënkupton se ai nuk ka përdorur burime të huaja për financimin e tij, si hua apo dhurime, por nuk mund të konsiderohet se ky pohim përjashton përdorimin e të ardhurave të krijuara nga shitja e një pasurie të mëparshme të tij, e cila nga ana tjetër është financuar po me të ardhurat nga puna, duke qenë se subjekti nuk deklaroi as për krijimin e saj të ardhura që vijnë nga burime të jashtë atyre nga puna.

14.4.4. Në pikën fundore, në vlerësimin e trupit gjykues, përfshirja e kësaj shume si pjesë e të ardhurave të vitit 2004, e cila është siguruar nga subjekti para blerjes së automjetit të ri, e bën të pavlerë diskutimin nëse ka shërbyer ose jo si burim vetëm për blerjen e automjetit të ri, pasi në çdo rast kjo e ardhur ka shkuar për të mbuluar shpenzimet e jetesës së subjektit në këtë vit, duke i dhënë mundësi atij që me të ardhurat nga punësimi të financojë blerjen e automjetit të ri, në muajin nëntor të këtij viti.

14.4.5. Në përfundim të analizës, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i ankimit të subjekti se në analizën e vitit 2004 duhet përfshirë si e ardhur shuma 250.000 lekë e siguruar nga shitja e automjetit, me anë të kontratës noteriale të datës 21.10.2004, me nr. {***} rep., e nr. {***} kol., është një pretendim i drejtë, i argumentuar dhe i mbështetur në prova.

- 15.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësonit se *analiza financiare e Komisionit për automjetin tip "Mercedes-Benz" 250D është kryer në mënyrë të gabuar së bashku me analizën e kursimeve në cash të deklaruara si të disponuara në vitin 2004, kur ndërkohë duhet të ishte e ndarë duke u ndalur deri në ditën e blerjes së automjetit*, trupi gjykues analizon dhe vlerëson sa vijon.

15.1. Në vendimin e Komisionit, lidhur me analizën financiare të vitit 2004, është arsyetuar se: *Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e administruar, kreu analizën financiare për vitin 2004, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit për blerjen e automjetit, krijim*

të kursimeve cash 900.000 lekë, dhe kryerjen e shpenzimeve deri në datën 31.12.2004, konkretisht: [...] Gjithashtu, pretendimi i subjektit se edhe po të merret vlera 5.300 euro si çmim blerjeje për automjetin subjekti i rivlerësimit rezulton me mundësi financiare për blerjen e tij, nuk rezulton të mbështetet nga faktet e hetimit administrativ, pasi rezultoi se subjekti ka deklaruar në të njëjtin vit në DIPP/2004 edhe gjendje cash në vlerën 900.000 lekë, me përshkrimin “Të akumuluar gjatë vitit 2004 nga pagat dhe kredia e marrë”.

15.2. Qëndrimet e mësipërme të Komisionit, si dhe aktet e fashikullit të hetimit administrativ evidentojnë se analiza financiare, lidhur me mundësinë e subjektit për të financuar me të ardhura të ligjshme blerjen e automjetit në vitin 2004, është bërë e integruar, së bashku me analizën për mundësinë e tij për të krijuar me të ardhura të ligjshme kursimet cash në shumën 900.000 lekë, të deklaruara në DVP-në 2004. Me ankimin, subjekti i rivlerësimit, ashtu siç ka pretenduar në Komision, kërkon që analiza financiare për automjetin të bëhet e ndarë nga analiza për mundësinë e krijimit me burime të ligjshme të gjendjes cash, duke argumentuar se këto dy pasuri (automjeti dhe likuiditeti në cash) nuk duhet të trajtohen të pandara me njëra-tjetrën, pasi ato janë krejt të ndryshme nga natyra e tyre, si dhe janë krijuar në momente të ndryshme të vitit 2004. Subjekti pretendon se nisur nga kronologjia e ngjarjeve, blerjes së automjetit dhe ajo e krijimit të kurimeve në cash, me një logjikë të thjeshtë, blerja e automjetit mund të ketë ndikim në krijimin e gjendjes së cash dhe jo e kundërta.

15.3. Në funksion të shqyrtimit të këtij pretendimi, trupi gjykues konstatoi se prej Komisionit kjo analizë është bërë duke i trajtuar këto dy pasuri së bashku si pjesë e analizës tërësore të vitit 2004, dhe se ashtu siç pretendon subjekti konstatohet se rezultati negativ i vitit 2004 është konkluzion përmbledhës i kontrollit të burimeve të krijimit të automjetit, si dhe të kursimeve në cash të këtij viti.

Në kushtet kur automjeti është blerë nga subjekti i rivlerësimit në muajin nëntor 2004 dhe të faktit që kursimet në cash, të cilat i përkasin këtij viti kalendarik, materializohen deri në fund të muajit dhjetor 2004, trupi gjykues vlerëson se analiza për to, të paktën lidhur me krijimin e pasurisë automjet, duhet të bëhet deri në momentin e krijimit të saj në tetor 2004, duke konsideruar në këtë analizë edhe faktin se kursimet në cash janë deklaruar si të krijuara nga pagat dhe kredia e cila është disbursuar në muajin dhjetor 2004. Në reflektim të qëndrimit të mësipërm, tek i cili, në ndryshim nga Komisioni, trupi gjykues ka argumentuar se pjesë e të ardhurave të vitit 2004 duhet të bëhet edhe shuma prej 250.000 lekësh e përfituar prej subjektit nga shitja e automjetit të vjetër në tetor të këtij viti, analiza financiare e kryer deri në momentin e blerjes së automjetit të ri [në shumën 5.300 euro + 220.000 detyrimet doganore], në nëntor 2004 rezulton me balancë pozitive.

15.4. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues, lidhur me automjetin tip “Mercedes-Benz” 250D, i blerë në vitin 2004, ashtu si edhe Komisioni, vlerëson të drejtë dhe të argumentuar kryerjen e analizës financiare për këtë automjet, duke konsideruar se subjekti i rivlerësimit ka shpenzuar për blerjen e tij vlerën 894.578 lekë (përbërë nga çmimi i shitjes 5.300 euro + 220.000 lekë shpenzime doganore). Pavarësisht këtij qëndrimi, trupi gjykues vlerëson se deklarimi i çmimit të blerjes së kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë vetting, në përputhje me atë të përcaktuar në kontratën e shitblerjes së tij, e ndryshme nga ai i llogaritur për efekt të analizës financiare, nuk kualifikohet si një deklaram i pasaktë, por si një fakt për të cilin subjekti dështoi të provojë të kundërtën e barrës së provës, situatë e cila nuk njehsohet me atë të

kualifikueshme, sipas leximit *a contrario* të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, siç Komisioni ka konkluduar.

15.5. Për këtë pasuri, trupi gjykues, në ndryshim nga Komisioni, vlerëson të drejtë pretendimin e subjektit se analiza financiare duhet të kryhet duke verifikuar mundësinë e subjektit për të ardhura të ligjshme deri në ditën e blerjes së këtij automjeti më datë 23.11.2004, dhe se si pjesë e të ardhurave të periudhës janar – nëntor 2004, duhet të përfshihet edhe shuma prej 250.000 lekësh, e deklaruar si e ardhur nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, si e siguruar nga shitja me anë të kontratës noteriale të datës 21.10.2004, nr. {***} rep., e nr. {***} kol., të një automjeti tjetër në pronësi të tij.

15.6. Nga kontrolli i kryer analizës financiare të Komisionit, mbështetur në dy elementet e përmendur më lart, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, më datë 23.11.2004, dispononte të ardhura të ligjshme për të financuar blerjen e automjetit në shumën 894.578 lekë. Për rrjedhojë, trupi gjykues konstaton se konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiarë të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie nuk është i drejtë, i bazuar në prova dhe në ligj.

16. Në vijim, trupi gjykues mori në analizë *pretendimet e subjektit referuar gjendjes cash prej 900.000 lekësh të deklaruar prej tij në DPV-në 2004*, për të cilën analizon dhe vlerëson sa vijon.

16.1. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, lidhur me gjendjen *cash* prej 900.000 lekësh të deklaruar në DVP-në 2004, pretendon se, siç ka shpjeguar në Komision, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, kjo shumë i përket gjendjes *cash* të disponuar prej tij në fund të marsit 2005, me burim krijimi kryesisht kredinë e disbursuar në dhjetor të vitit 2004, e cila është tërhequr prej tij në janar 2005. Sipas subjektit, në gjendjen *cash* të deklaruar ka kontribuar si burim edhe shuma prej 250.000 lekësh që përfaqëson të ardhurat nga shitja e automjetit në tetor të vitit 2004, si dhe nga shuma prej 100.000 lekësh, pjesë e kredisë e tërhequr prej subjektit nga llogaria e tij bankare në fund të vitit 2004, e cila nga Komisioni, sipas subjektit, është konsideruar gabimisht si shpenzim. Sipas subjektit, balanca negative e analizës së gjendjes së *cash*-it të deklaruar prej tij duhet të rezultojë në shumën 50.000 lekë⁶.

Subjekti, pretendon për vendosje të gabuar në analizën financiare të Komisionit në zërin “Ndryshim mjetesh monetare në bankë” (*dokumentuat gjendja në fillim – gjendja në fund*) të shumës prej 500.000 lekësh, e cila është konsideruar si shpenzim, i cili e ka ngarkuar analizën pa të drejtë, pasi kjo llogari bankare nuk ka pasur likuiditet në fund të vitit 2004 dhe gjendja e raportuar nga Raiffeisen Bank i përket marsit të vitit 2005.

16.2. Trupi gjykues, siç ka evidentuar edhe më sipër, konstaton se analiza e Komisionit për vitin 2004 është kryer së bashku për të dy pasuritë, si automjeti po ashtu dhe gjendja *cash*, meqenëse janë deklaruar si të krijuara në fund të këtij viti. Referuar burimit të krijimit të gjendjes *cash*, Komisioni ka argumentuar se kredia e deklaruar si burim krijimi i kësaj pasurie likuiditet është

⁶ Analiza e subjekti të rivlerësimit për krijimin e gjendjes së *cash*-it të deklaruar në DVP 2004 në vlerën 900.000 lekë me burime:

- kredia tërhequr në janar 2005 ----- 500.000 lekë;
- kredia tërhequr në dhjetor 2004 ----100.000 lekë;
- të ardhura nga shitja e makinës-----250.000 lekë;
- mjete monetare të disponueshme--- 50.000 lekë.

disbursuar në llogari në fund të vitit 2004 dhe është tërhequr pjesërisht nga subjekti, vetëm 100.000 lekë, në këtë vit dhe, si e tillë, nuk mund të ketë shërbyer për krijimin e likuiditetit në gjendjen *cash* të deklaruar prej tij. Gjithashtu, rezulton se shuma prej 100.000 lekësh e tërhequr prej subjektit nga kredia në fund të vitit 2004 në analizën e Komisionit është përfshirë në “*kategorinë e shpenzimeve*”, me argumentin se qëllimi i kredimarrjes ka qenë shlyerja e një huaje dhe jo krijimi i gjendjeve likuiditet në *cash*. Bazuar në sa më sipër, analiza e konsoliduar e Komisionit, që ka përfshirë të dy pasuritë, automjetin dhe gjendjen *cash*, për vitin 2004, ka rezultuar me balancë negative në shumën (-) 656.698 lekë.

16.3. Trupi gjykues, referuar dokumentacionit të disponuar në fashikullin e hetimit administrativ, konstaton se kredia e marrë nga subjekti në ProCredit Bank, në shumën prej 600.000 lekësh, ka qenë kredi konsumatore me qëllim “*shlyerjen e borxheve ndaj një miku për makinën që ai ka blerë*”, por gjatë hetimit administrativ nga Komisioni nuk është identifikuar ndonjë detyrim i shlyer nga subjekti në momentin e tërheqjes së shumës 100.000 lekë nga banka në fund të vitit 2004, si dhe të pjesës tjetër të mbetur të kredisë së tërhequr në janar të vitit 2005. Rezulton se subjekti ka tërhequr shumën 100.000 lekë në datën 29.12.2004 dhe në DVP-në e vitit 2004 ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 900.000 lekë me burim *dhe kredinë e marrë*. Referuar deklaramit nga subjekti në DVP-në e vitit 2004, për burimin e krijimit të gjendjes *cash me kredinë e marrë në bankë*, trupi gjykues, shumën e tërhequr nga kredia në vlerën prej 100.000 lekësh në dhjetor të vitit 2004, ndryshe nga Komisioni, nuk e konsideroi si shpenzim, sa kohë që një veprim i tillë nuk evidentohet në asnjë formë, por në përputhje me deklaramet e subjektit në DVP-në 2004, në kuptim edhe të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, e konsideroi si një e ardhur që ka shërbyer për krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar.

16.4. Gjithashtu, trupi gjykues, duke u bazuar në deklaramin e bërë nga subjekti në DVP-në 2004, vlerësoi të konsiderojë të besueshëm shpjegimin e tij se në kohën e dorëzimit të kësaj deklarate, në mars 2005, ai kishte tërhequr nga banka të gjithë shumën e disbursuar të kredisë në vlerën prej 600.000 lekësh, të cilën, për shkak të një leximi jo të duhur të detyrimit për deklaram, e ka përfshirë si pjesë të likuiditetit në *cash*, të deklaruar si gjendje në këtë deklaratë. Trupi gjykues mban në konsideratë në këtë vlerësim faktin se shuma prej 500.000 lekësh, si një pjesë e kredisë, është tërhequr fizikisht nga banka prej subjektit në datën 13.01.2005, ndërsa shuma prej 100.000 lekësh ishte tërhequr në dhjetor 2004, rrethanë që bën të arsyeshëm dhe të besueshëm deklaramin e subjektit se ai ka perceptuar ta deklarojë atë në DVP-në 2004, duke mos pasur një koncept të qartë për diferencën mes likuiditetit në bankë dhe atij *cash*. Pavarësisht pasaktësisë në deklaram, pasi kjo shumë duhej deklaruar në DVP-në 2004, si gjendej likuiditet në bankë, trupi gjykues i dha peshë deklaramit përshkrues së subjektit në këtë deklaratë se burim i krijimit të gjendjes *cash* është kredia, e cila në dhjetor 2004 ishte disbursuar në llogarinë e subjektit dhe në datën 31.12.2004 ishte gjendje në këtë llogari në vlerën prej 500.000 lekësh. Në mbështetje të këtij vlerësimi shkon edhe fakti se deklarami i subjektit do të ishte krejtësisht dhe haptazi alogjik, që në një vit kalendarik, në të cilin të ardhurat janë gjithsej në vlerën prej 1.000.000 lekësh, ai pasi kishte shpenzuar për jetesë, kishte krijuar edhe pasuri, të kishte kursyer në *cash*, edhe shumën prej 900.000 lekësh. Një deklaram i tillë mund të suportohet logjikisht vetëm nëpërmjet shpjegimit që ai vetë ka bërë në DVP-në 2004, se si burim për krijimin e kësaj gjendje ka shërbyer kredia e marrë nga banka në fund të vitit.

16.5. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues e gjeti bindës deklarin e subjektit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, se gjendja e *cash-it* ishte krijuar nga fonde të akumuluar gjatë vitit 2004 me burim nga paga dhe kredia e marrë, pavarësisht deklarin të pasaktë në këtë deklaratë për vendin e depozitimit të likuiditeteve, për shkak të faktit se këto fonde në datën 31.12.2004 ekzistonin kryesisht në llogari bankare dhe jo në banesë. Sipas këtij vlerësimi, trupi gjykues, pasi kontrollon nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor analizën e kryer nga Komisioni, konstatoi se subjekti i rivlerësimit rezultoi të ketë në fund të vitit 2004 një balancë negative për të përballuar krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve në vlerën prej (-) 56.698 lekësh, situatë e cila kualifikohet sipas nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

17. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, me të cilat kundërshton *analizën e Komisionit për gjendjen cash prej 650.000 lekësh të deklaruar në deklaratën vetting, duke pretenduar se kjo analizë është jo e saktë për shkak të aplikimit të një metodologjie të gabuar*, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon.

17.1. Në vendimin e Komisionit, lidhur me gjendjen *cash* prej 650.000 lekësh, të deklaruar prej subjektit në deklaratën *vetting*, është konkluduar se krijimi i kësaj shume i përket periudhës 01.01.2017 - 30.01.2017, për shkak se subjekti nuk ka deklaruar kursime në DVP-të e viteve 2014, 2015 dhe 2016, dhe se konsiderimi i kësaj shume si e prejardhur prej kursimeve në *cash* të krijuara në vitin 2004, është i pabesueshëm, pasi subjekti ka qenë përgjatë kësaj periudhe në marrëdhënie kreditimi dhe në pamundësi shlyerje për to, duke e bërë jobindës pretendimin se gjendja *cash* është e krijuar në vite.

17.2. Subjekti i rivlerësimit kundërshton si të pabazuara dhe jo të drejta konkluzionet e Komisionit, lidhur me gjendjen *cash* të deklaruar në deklaratën *vetting* në shumën 650.000 lekë, duke pretenduar se: (i) analiza e Komisionit, e cila kërkon të provojë mundësinë për krijimin e kësaj shume vetëm gjatë muajit janar 2017⁷, është jo e drejtë dhe e gabuar; (ii) Komisioni nuk ka mbajtur në konsideratë se subjekti në vitet 2014, 2015 dhe 2016 ka pasur mundësi kursimi të larta që e tejkalojnë vlerën 650.000 lekë të deklaruar në deklaratën *vetting*; (iii) Komisioni nuk ka konsideruar se edhe vetëm me të ardhurat e vitit 2016 ka pasur mundësi të krijoj shumën 650.000 lekë, duke pretenduar se mosdeklarimi i këtyre kursimeve si likuiditete *cash* në DVP-në 2017 është një pakujdesi apo pasaktësi që nuk duhet të rëndojë në procesin e tij të rivlerësimit.

17.3. Trupi gjykues, nga analizimi i të dhënave që lidhen me këtë pasuri, konstaton se subjekti ndër vite ka bërë vetëm njëherë deklarin për gjendje *cash* dhe është deklarin i bërë në vitin 2004, i cili u analizua më lart. Përtej këtij deklarimi nuk gjen në deklaratat periodike të subjektit deklarime për krijim të ndonjë gjendje *cash* ndër vite, përveç deklarin të bërë në deklaratën *vetting* për gjendjen prej 650.000 lekësh, si i krijuar me të ardhura personale nga pagat. Gjithashtu, rezultoi se subjekti ka dhënë shpjegime rreth gjendjes *cash* në ILDKPKI, në shkurt të vitit 2016. Për pyetjen: *Në deklarinin e vitit 2004 keni deklaruar se zotëroni likuiditete në*

⁷ Sipas vendimit: Komisioni kreu një analizë financiare për periudhën 01.01.2017 – 30.01.2017, mbështetur në dokumentacionin e administruar, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit për krijimin e kursimeve *cash* në vlerën 650.000 lekë, në datën 30.01.2017, paraqitur në tabelën si vijon: [...] Nga përlllogaritja sipas kësaj metode Komisioni ka evidentuar se subjekti është me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e likuiditeteve në *cash* në shumën (-) 545.921 lekë.

cash në shumën 900.000 lekë? A vijoni t'i zotëroni? Saktësoni vlerën e tyre deri më 31.12.2014, ai është përgjigjur: Vijoje t'i zotëroj është e njëjta shumë.

17.4. Në kushtet e mësipërme, fillimisht Komisioni ka konsideruar mundësinë e prejardhjes së gjendjes *cash* të deklaruar në deklaratën *vetting*, prej asaj të deklaruar në vitin 2004. Subjekti e ka kundërshtuar në shpjegimet ndaj rezultateve të hetimit këtë trajtim dhe në ankim po ashtu, duke pretenduar se kjo gjendje i përket kursimeve të viteve 2014, 2015 dhe 2016, duke potencuar këtë të fundit, me shpjegimin se mosdeklarimi i kursimeve në këto vite është vetëm një pasaktësi në deklaratimet e tij periodike, por që nuk mund ta penalizojë, sepse ai ka pasur mundësi të krijojë kursime, të cilat do të justifikonin krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar në deklaratën *vetting*.

17.5. Komisioni, në funksion të kontrollit të kësaj pasurie, ka marrë në analizë periudhën 2005-2016, duke konstatuar se subjekti në DVP-në 2004 ka deklaruar se kursimet në *cash* janë krijuar me burim të ardhurat nga pagat dhe nga kredia. Ndërkohë, ka rezultuar se kredia e marrë në ProCredit Bank është marrë me *qëllim shlyerjen e borxhit ndaj një miku për blerje automjeti*, fakt që e ka çuar Komisionin në marrjen në analizë të historikut të kredive të marra dhe të shlyera nga subjekti i rivlerësimit ndër vite. Nga kjo analizë ka rezultuar se subjekti ndër vite⁸ ka marrë kredi konsumatore nga banka të ndryshme të nivelit të dytë, për likuidimin e të cilave ka pasur problematika, madje për shlyerjen e tyre ka lidhur edhe marrëveshje me shoqëri huadhënëse. Po ashtu, rezulton se ndaj subjektit një zyrë përmbarimore ka nxjerrë urdhër për ndalimin e tjetërsimit të pronësisë së automjetit në pronësi të tij, si masë paraprake për të shlyerjen e kredisë që subjekti kishte marrë pranë NBG. Gjendur para këtyre të dhënave, rezulton se prej Komisionit informacioni për marrjen e disa kredive konsumatore nga subjekti, si dhe problemet e zgjata në likuidimin e tyre, është konsideruar se ka pamundësuar subjektin të disponojë nga viti 2004 deri në janar 2017, shumën prej 650.000 lekësh, të deklaruar si likuiditet *cash* në deklaratën *vetting*.

17.6. Trupi gjykues, në vlerësim të situatës si më sipërrasyetuar, konsideron të rëndësishme për zgjidhjen e çështjes faktin që subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer deklarime të

⁸ Kreditë e marra nga subjekti, pas asaj të disbursuar në vitin 2005 nga Pro Credit Bank, e cila është marrë me qëllim "qëllim shlyerjen e borxhit ndaj një miku për blerje automjeti" janë si vijon dhe për to Komisioni ka evidentuar se:

a) Kredia konsumatorë, datë 06.06.2006, me Raiffeisen Bank, në shumën 700.000 lekë.

Në Komision, subjekti ka shpjeguar se kjo kredi ka qenë konsumatore dhe është marrë me qëllim blerje pajisjesh dhe orendish. Komisioni, në vendim, evidenton se: Në dokumentacionin e administruar në dosjen e ILDKPKI-së rezulton se subjekti ka qenë në pamundësi likuidimi detyrimi ndaj Raiffeisen Bank për kredinë dhe overdraft-in. Me marrëveshjen lidhur ndërmjet shoqërisë huadhënëse "{***}" ShPK dhe subjektit të rivlerësimit në cilësinë e huamarrësit, detyrimet për kredinë në vlerën 485.854,16 lekë ndaj Raiffeisen Bank dhe overdraft-i në vlerën 151.615,28 lekë i kanë kaluar shoqërisë huadhënëse. Mbi bazën e kësaj marrëveshjeje, duke nisur nga data 27.06.2013, huamarrësi është debitor ndaj shoqërisë "{***}" ShPK., për detyrimin e shumës 380.000 lekë, e cila do të paguhet prej tij me këste mujore me vlerë 20.000 lekë, për periudhën janar 2017 – korrik 2018.

b) Kredia konsumatore, datë 06.09.2007, me National Bank of Greece, në shumën 500.000 lekë, për qëllim (mobilje pajisje).

Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit rezulton klient me vonesë ndaj bankës që prej datës 06.09.2010, me vlerën e detyrimit 365.673,30 lekë, me kontratën e shërbimit, NBG ka kërkuar nga zyra përmbarimore vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv kontratë kredie bankare, datë 21.08.2007. Nga aktet e administruara në dosjen e DPShTRr-së, përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 09.02.2021, zyra përmbarimore "{***}", me shkresë i paraqiti kërkesë DPShTRr-së për moskryerjen e asnjë veprimi për ndryshim pronësie, nëse ekziston automjet në emër të subjektit, duke marrë masën e bllokimit të veprimeve deri në një urdhër të dytë. Me urdhër zyra e përmbarimit vendosi heqjen e sekuestros konservative mbi automjetin e subjektit, pasi në datën 10.03.2014 pala debitore shleu tërësisht detyrimin ndaj NBG-së.

gjendjes/kursimeve në *cash* në vitet kur ai pretendon se është krijuar kjo gjendje, respektivisht në DVP-të 2014, 2015 e veçanërisht 2016. Duke pranuar shpjegimet e subjekti se gjendja *cash* e deklaruar në deklaratën *vetting* nuk e ka burimin prej gjendjes *cash* të krijuar në vitin 2004, qoftë për faktin se kjo rrethanë pohohet prej tij si i vetmi burim që mund të konfirmojë këtë fakt, ndonëse ka deklaruar ndryshe në ILDKPKI në shkurt të vitit 2016, në kushtet e mospasjes së asnjë gjurme në deklaratat periodike të pasurisë, por qoftë edhe në këndvështrim të faktit se, siç ka analizuar Komisioni, subjekti ka rezultuar për gjatë gjithë periudhës së marrë në analizë në marrëdhënie kreditore konsumatore, fakt që tregon për vështirësi në pasjen e likuiditeteve, duket krejtësisht e arsyeshme që gjendja *cash* prej 650.000 lekësh e deklaruar në deklaratën *vetting* të mos e ketë burimin prej asaj të krijuar në vitin 2004.

17.7. Për sa më lart, trupi gjykues u fokusua në analizimin e DVP-ve 2014, 2015 e 2016, në të cilat subjekti, gjithashtu, nuk ka deklaruar kursime të krijuara në secilin vit, pavarësisht analizës financiare, e cila potencialisht duket se rezultonte me balanca pozitive në këto vite. Pretendimi i subjektit se mosdeklarimi i kursimeve në *cash* në këto vite e sidomos në vitin 2016 është vetëm një pakujdesi, mbetet pa efekt në vlerësimin e situatës prej trupit gjykues, për sa kohë, jurisprudenca e konsoliduar e Kolegjit ka përcaktuar se deklaratat periodike në vite, sidomos për provueshmërinë e gjendjes së kursimeve në *cash*, kanë një vlerë të shtuar, përtej asaj që përcakton neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në kushtet kur kjo lloj pasurie nuk mund të provohet me mënyra të ndryshme. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se analiza që Komisioni ka bërë për krijimin e gjendjes *cash* në deklaratën *vetting*, si të krijuar në janar të vitit 2017, është e drejtë.

17.8. Në përfundim, në përmbledhje të qëndrimeve të mësipërme, trupi gjykues, lidhur me gjendjen *cash* në shumën 650.000 lekë të deklaruar si të disponuar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, konsideroi të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti gjendej në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme në shumën prej (-) 545.921 lekësh, për ta krijuar atë në periudhën 01.01.2017 - 30.01.2017, si periudha e vetme për të cilën gjenden deklaratime të subjektit për krijimin dhe ekzistencën e kësaj shume. Pretendimet e subjektit se kjo shumë është krijuar prej tij përgjatë viteve 2014, 2015 dhe sidomos vitit 2016, për shkak të balancave pozitive në analizën e tij financiare të kryer nga Komisioni, u gjetën prej trupit gjykues të pambështetura në asnjë prej deklarimeve periodike të subjektit në këto vite, si të vetmet dokumente ligjorë, të cilat mund të provojnë disponimin e gjendjes *cash* prej subjekteve të rivlerësimit. Në këto kushte, pavarësisht balancave pozitive hipotetike të rezultuara nga analiza e kryer në Komision, por edhe të konfirmuara në Kolegji, mbështetur edhe në jurisprudencën e Kolegjit lidhur me provueshmërinë e gjendjes *cash*, si edhe në konsideratë të situatave të vështira financiare të subjektit të rivlerësimit në vite, lidhur me shlyerjen e disa kredive konsumatore, trupi gjykues konfirmoi mungesën e burimeve të ligjshme të rezultuar nga Komisioni lidhur me krijimin e saj, e cila kualifikohet sipas nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

18. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka gabuar në qëndrimin e mbajtur lidhur me adresat e tij të banimit, dhe se konkluzioni që banesa e vëllezërve të tij është pasuri e fshehur e subjektit është produkt i kësaj analize hamendësuese, e cila nuk përkon me realitetin dhe nuk është e bazuar në fakte dhe prova, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson sa vijon.

18.1. Komisioni ka marrë në analizë situatën faktike që ka rezultuar gjatë hetimit e që lidhet me faktin që subjekti i rivlerësimit ka banuar në disa adresa të ndryshme banimi ndër vite, situatë e cila i atribuohet faktit se subjekti nuk ka pasur në pronësi të tij një banesë personale, as në qytetin e Ersekës, ku ka banuar deri në vitin 2007 dhe as në qytetin e Korçës, deri në vitin 2023, kur ai ka blerë të parën pasuri të paluajtshme në pronësi të tij. Për shkak të kësaj situatë, subjekti ka deklaruar në DVP-të ndër vite, por edhe gjatë hetimit administrativ, banimin në disa adresa të ndryshme, në të cilat ka qëndruar herë në marrëdhënie qiraje e herë pa pagesë, duke qenë se ka banuar në shtëpinë e familjarëve të tij për periudha të caktuara. Meqenëse nga hetimi ka rezultuar se, ndonëse subjekti ushtronte detyrën e prokurorit në Korçë, për një periudhë kohë ai figuronte, sipas të dhënave të Regjistrisë të Gjendjes Civile⁹, me vendbanim në fshatin Mollas të Kolonjës apo në Ersekë. Komisioni, gjatë hetimit administrativ, me pyetësorin shtesë nr. 2, datë 27.02.2024, i ka kërkuar atij shpjegime dhe dokumentacion mbi adresat e banimit të cilat figuron i regjistruar në gjendjen civile gjatë viteve 2008 – 2010 dhe 2012 – 2016. Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar se: *Pas transferimit të tij në Korçë në vitin 2007, familja e motrës ka marrë me qira një banesë në këtë qytet, në lagjen Nr. {***}. Një periudhë kohe ka banuar në shtëpinë e së motrës dhe pjesën tjetër në banesën e vëllezërve të tij, A. N. dhe F. N. Në vitin 2010, familja e së motrës ka blerë një apartament në qytetin e Korçës, në të cilin subjekti deklaron se ka jetuar deri në prill të vitit 2012.*

18.1.1. Komisioni, pasi ka analizuar deklaratimet e subjektit lidhur me adresat e banimit, ka konkluduar se ai *ka dhënë deklarime e shpjegime të pasakta dhe kontradiktore lidhur me vendbanimet e tij dhe të paprovuar, për sa i përket mungesës së koherencës në deklarime, përpjekjet e subjektit të rivlerësimit për të deformuar të vërtetën në funksion të paraqitjes së të dhënave lidhur me vendbanimet e tij, e vendosin atë në kushtet e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pikës 3 të nenit 61, si dhe të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.*

18.1.2. Komisioni, duke analizuar në vijim rrethanat e faktit që lidheshin me përdorimin prej subjektit të banesës së vëllezërve të tij për banim, për një periudhë përreth dyvjeçare, ka ngritur dyshime rreth të drejtave të subjektit në këtë pasuri, për shkak të përdorimit të saj dhe ka analizuar në funksion të këtyre dyshimeve mundësitë financiare të vëllezërve për krijimin e saj, godinë dykatëshe e ndodhur në Koçë. Pas vlerësimit të kësaj situatë, Komisioni ka arsyetuar se subjekti, jo vetëm që ka qenë i paqartë dhe jo konsekuent në deklaratimet e tij rreth përdorimit të kësaj prone, por edhe nuk ka depozituar dokumentacion ligjor që justifikon të ardhurat e ligjshme të vëllezërve të tij për ndërtimin e kësaj pasurie në vitin 2000 në shumën 6.167.140 lekë për t’i investuar në ndërtimin e këtij objekti, duke pamundësuar Komisionin të bëjë një vlerësim fundor dhe objektiv rreth verifikimit të faktit se ku ka jetuar në këto vite subjekti i rivlerësimit.

⁹ Në vendimin e Komisionit lidhur me konfirmimet e gjendjes civile evidentohet sa vijon:

Zyra e Gjendjes Civile, Bashkia Korçë, me shkresë informon se subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës 01.01.2003 – 31.3.2005 ka qenë me vendbanim në fshatin {***}, Njësia Administrative {***}, Bashkia Kolonjë.

Në datën 31.03.2005 është shpërngulur me vendbanim në Zyrën e Gjendjes Civile Ersekë. Në periudhën 31.03.2005 – 23.11.2007 ka qenë me vendbanim në qytetin e Ersekës.

Në datën 23.11.2007 është shpërngulur me vendbanim në Zyrën e Gjendjes Civile, Njësia Administrative Korçë. Referuar të dhënave nga Zyra e Gjendjes Civile, njësia administrative Korçë, gjatë periudhës 15.11.2007 – 31.12.2017 ka qenë me vendbanim në qytetin e Korçës, në adresën: lagjja Nr. {***}, rruga “{***}”, pallati nr. {***}. [...].

18.1.3. Në konkluzion të këtij arsyetimi, Komisioni ka vlerësuar se *subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime të pasakta dhe kontradiktore, duke e vendosur organin e rivlerësimit në kushtet e pamundësisë objektive për të kontrolluar pasuritë në përdorim nga subjekti i rivlerësimit dhe burimet e ligjshme të krijimit të tyre dhe e vendosin subjektin në kushtet e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pikës 3 të nenit 61, si dhe cenojnë shkallën e besueshmërisë së tij në zbatim të pikës 2 të nenit 4 dhe pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

18.2. Subjekti i rivlerësimit me ankimin kundërshton si tërësisht të pabazuar këtë konkluzion të Komisionit, duke pretenduar se nuk janë marrë në konsideratë shpjegimet e tij për sa vijon: (i) mosdeklarimi i adresave të plota në deklaratat vjetore periodike nuk është bërë me qëllim, por ka qenë një lapsus; (ii) pretendimi që mosdeklarimi i adresave ka qenë një lapsus provohet nga fakti se në momentin që subjekti është pyetur nga Komisioni të deklaroj të gjitha adresa të tij të banimit, ai pa hezitimin më të vogël, ka deklaruar të gjitha adresat dhe vendqëndrimet të cilat rezultojnë të jenë të ndryshme nga adresa sipas akteve të gjendjes civile, duke evidentuar se duhet konsideruar se që prej vitit 1992 ai ka qenë familje më vete i ndarë nga familja e tij e origjinës; (iii) mosdeklarimi i shpenzimeve për qiratë e apartamenteve ku ka jetuar ka ndodhur për shkak se ato si shpenzim nuk e kalonin shumën 300.000 lekë në vit dhe, për pasojë, nuk ka pasur detyrim për deklarim e këtij shpenzimi; (iv) Komisioni, në mënyrë të gabuar, duke përkeqësuar pozitën e subjektit, ka pretenduar se banesa e vëllezërve të tij ka qenë në përdorim nga subjekti. Ai ka qëndruar në këtë banesë në momente të caktuara, kur atje banonin edhe poseduesit e saj, vëllezërit e tij, duke shpjeguar se ky qëndrim lidhej me faktin se duhet t'i qëndronte pranë nënës së tij; (v) Komisioni nuk është bazuar në asnjë të dhënë apo dokument kur ka konsideruar se ai ka/disponon pjesë në banesën e vëllezërve të tij.

18.3. Nga shqyrtimi akteve të hetimit ka rezultuar se subjekti, në deklaratën *vetting*, ka deklaruar si adresë banimi: “Lagja nr. {***}, rruga “{***}”, {***}/H{***}/ap. {***}, {***}, Korçë”. Në deklaratat vjetore periodike¹⁰, ai deklaruar adresat e banimit në mënyra të ndryshme dhe jo me të gjithë elementet që kërkohen për të identifikuar një adresë banimi, si edhe ka deklaruar adresa banimi në Korçë, të cilat nuk identifikohen më si të tilla, pasi emërtimi i njësive administrative ka ndryshuar. Kjo formë/mënyrë e deklarimit të adresave ka krijuar një paqartësi dhe vështirësi për të identifikuar qartësisht vendin/banesën ku ka banuar subjekti dhe marrëdhënien që ai ka pasur me pasurinë e përdorur për banim.

18.4. Me shkresën nr. {***} prot., datë 09.02.2024, Zyra e Gjendjes Civile në Bashkinë Korçë, ka informuar Komisionin se subjekti i rivlerësimit: (i) gjatë periudhës 01.01.2003 – 31.03.2005 ka qenë me vendbanim në fshatin {***}, Njësia Administrative {***}, {***}, Bashkia Kolonjë; (ii) në datën 31.03.2005 është shpërngulur me vendbanim në Zyrën e Gjendjes Civile Ersekë dhe në periudhën 31.03.2005 – 23.11.2007 ka qenë me vendbanim në qytetin e Ersekës; (iii) në datën 23.11.2007 është shpërngulur me vendbanim në Zyrën e Gjendjes Civile Njësia Administrative Korçë; (iv) gjatë periudhës 15.11.2007 – 31.12.2017 ka qenë me vendbanim në qytetin e Korçës, në adresën: Lagja {***}, rruga “{***}”, p. {***}.

18.5. Nga sa më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting* ka deklaruar adresën tek e cila ai banonte realisht në momentin e plotësimit të kësaj deklarate, e

¹⁰ DVP-në fillestare 2003: “{***}” Ersekë; DVP-në 2004: “{***}” Ersekë; DVP-në 2005: “{***}” Ersekë; DVP-në 2006: “{***}” Ersekë; DVP-në 2007: lagja {***}, rruga “{***}”, Korçë; DVP-në 2008, DVP-në 2009 dhe DVP-në 2010 nuk ka deklaruar adresë banimi; DVP-në 2011, nuk ka plotësuar rubrikën e adresës së regjistruar të gjendjes civile, por në rubrikën a dispononi vendqëndrim tjetër ka deklaruar se vendqëndrimi i tij në këtë vit është rruga “{***}” Pallati {***}, A-{{***}}”; DVP-në 2012 dhe DVP-në 2013 vetëm shënimin “Korçë”; DVP-në 2014, DVP-në 2015 dhe DVP-në 2016, nuk ka deklaruar asnjë adresë; DVP-në 2017: lagja nr. {***}, rruga “{***}”, {***}/H{***}/ap. {***}, {***}, Korçë.

cila rezulton të përfaqësojë vendbanimin e tij në momentin e plotësimit të kësaj deklarate. Në këtë këndvështrim, deklarimi i tij në deklaratën *vetting* nuk rezulton të këtë pasaktësi apo paplotësi. Lidhur me deklaratimet e adresave në deklaratat vjetore periodike, subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar adresat e banimit apo të regjistrimit në gjendje civile në mënyrë të plotë e të saktë, për pasojë trupi gjykues çmon të drejtë konkluzionin se mungesa e deklaratimit të vendbanimit në deklaratat periodike vjetore pamundëson kontrollin e plotë lidhur me vendqëndrimet e tij, duke e bërë këtë kontroll “të varur” nga deklaratimet që subjekti ka bërë lidhur me adresat e banimit ndër vite vetëm gjatë hetimit administrativ

18.6. Në këto kushte, trupi gjykues, pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit në drejtim të konkluzionit të Komisionit për deklarim të pasaktë, lidhur me adresat e banimit në deklaratat periodike në vite, konstatoi se është i drejtë qëndrimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur qartësi dhe plotësi në deklaratat periodike për adresat e tij të banimit në çdo vit deklarimi, duke pasur në këtë mënyrë deklarime jo të plota në përputhje me kërkesat e modelit të deklaratës së miratuar për secilin vit deklarimi nga institucioni përgjegjës ILDKPKI-ja, të cilat, për më tepër, kërkonin deklarimin e adresës sipas regjistrimit në gjendjen civile. Pavarësisht kësaj pasaktësie, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë në deklaratën e pasurisë *vetting* adresën e banimit, e cila përputhet me vendin e tij të qëndrimit në kohën e nënshkrimit të kësaj deklarate, duke qenë se ai nuk dispononte një banesë në pronësi të tij në këtë kohë. Në këtë kontekst, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit, që subjekti ka bërë deklarime të pasakta, sipas nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, lidhur me deklaratat periodike në vite, nuk është i mbështetur në ligj, përderisa i referohet pasaktësive në deklaratat periodike dhe jo asaj *vetting*, pasaktësi të cilat nuk vlerësohen se kualifikohen sipas dispozitës së cituar prej Komisionit, përpos faktit se Komisioni nuk rezulton t’i lidhë ato me ndonjë dyshim apo çështje tjetër, e cila mund të vlerësohej në kuadër të procesit të rivlerësimit të subjektit. Trupi gjykues konstaton se këto pasaktësi duket se vijnë edhe për shkak të situatës specifike të subjektit të rivlerësimit, të mos pasjes në pronësi të një banese përgjatë këtyre viteve, rrethanë që ka diktuar edhe lëvizjen e tij në disa banesa të ndryshme në pronësi të personave të tjerë, duke prodhuar edhe një lloj mungese koherence dhe paplotësie në deklarimin e duhur të tyre.

18.7. Lidhur me pretendimet e subjektit që i adresohen konkluzionit të Komisionit për të drejta të tij në banesën e vëllezërve, trupi gjykues konstaton se duke marrë indicie nga shpjegimet që subjekti ka dhënë për adresat e banimit, në të cilat ka shpjeguar¹¹ se ka banuar disa kohë në banesën e vëllezërve A. N. dhe F. N., Komisioni ka kryer hetim lidhur me këtë pasuri të vëllezërve të subjektit duke evidentuar se ata disponojnë një godinë 2-katëshe¹² në proces

¹¹ Në përgjigjet për pyetëtorin 2 (shitesë) subjekti ka deklaruar se:

“Pas transferimit tim në Korçë në vitin 2007, duke qenë se nuk kishte dikë të kujdesej për banesën, familja e motrës, F. A., i transferoi orenditë shtëpiake që kishin në një banesë të tyre në Ersekë, në një banesë të marrë me qira në lagjen nr. {***}, Korçë. Unë kam qëndruar disa kohë në atë banesë dhe pjesën tjetër të kohës në banesën e vëllezërve të mi A. N. dhe F. N. Kështu kam vazhduar deri në vitin 2010. Në atë vit familja e motrës ka blerë një apartament në qytetin e Korçës. Në këtë apartament unë kam qëndruar deri nga muaji prill i vitit 2012. Në atë kohë motra dhe bashkëshorti i saj V. A. janë kthyer nga emigracioni për shkak të gjendjes shëndetësore të tij”.

¹² Në “Rezultatet e Hetimit Administrativ”, Komisioni evidenton se:

Nga dokumentacioni i administruar për legalizim rezulton se me dokumentin vetëdeklarim për legalizim, datë 14.11.2006, shtetasi A. E. N. ka nënshkruar formularin e vetëdeklarimit për objektin shtëpi, vit ndërtimi 2000, me sipërfaqe ndërtimi 145 m², sipërfaqe e zënë 209 m², me adresë “{***}”.

Me kontratën e shitblerjes datë 10.09.1998, ndërmjet shitësit S. M. dhe blerësit A. N. është blerë truall me sipërfaqe 193 m² në vlerën 579.457 lekë. Komisioni, me shkresën nr. {***} prot., datë 21.03.2024, drejtuar FShU-së, kërkoi informacion mbi kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe ndryshimet e tyre për objektin pa leje në Korçë, nga ku rezultoi se referuar sistemit të faturimit ka 2 kontrata furnizimi me energji elektrike, të cilat u

legalizimi me adresë të deklaruar në formularin e kërkesës për legalizim, si “Rruga “{***}” L. {***}, {***} Korçë”, për të cilën nuk është provuar se vëllezërit kanë pasur të ardhura të ligjshme për ndërtimin e saj. Po ashtu, Komisioni, në rezultatet e hetimit administrativ, ka evidentuar se vëllai i subjekti F. N., dhe pse disponon një objekt në proces legalizimi në Korçë, gjendja e tij civile vazhdon të mbetet e regjistruar në fshatin {***}, Bashkia Kolonjë, ndërsa vëllai tjetër A. N., nga data 01.01.2007 dhe në vazhdim ka qenë me vendbanim në qytetin e Korçës, në adresën Lagjja {***}, “{***}”, përditësuar sipas adresarit, në adresën Lagjja {***}, rruga “{***}”, nr. {***}, që janë adresa banimi të ndryshme nga godina dykatëshe e deklaruar se është në pronësi të tyre. Mbështetur në këto të dhëna, Komisioni ka konkluduar se subjekti e ka vendosur atë në pamundësi për të kontrolluar këtë pasuri, duke u gjendur në kushtet e nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016.

18.8. Subjekti i rivlerësimit, me përgjigjet e dhëna për rezultatet e hetimit administrativ në Komision, ashtu edhe me ankimin, pretendon se nuk duhet të konsiderohet si posedues i një pjese të banesës së vëllezërve të tij dhe se kjo banesë nuk duhet konsideruar si banesë e familjes së tij të origjinës, pasi pretendon se ky objekt i përket vetëm vëllezërve të tij A. dhe F. N., të cilët e kanë ndërtuar atë me të ardhurat nga puna dhe emigracioni. Subjekti, evidenton faktin se që prej vitit 1992 nuk ka qenë në të njëjtën gjendje familjare me vëllezërit dhe nënën e tij, si dhe thekson se vetëm për 2 vite ai ka qëndruar në shtëpinë e vëllezërve, pasi aty banonte edhe nëna, me të cilën ka jetuar në një dhomë për ta ndihmuar, duke iu gjendur pranë asaj deri në momentet e fundit të jetës. Mungesa e deklarimit në deklaratat periodike vjetore, se ka banuar për disa kohë në banesën e vëllezërve, kurrësi nuk mund të konsiderohet si e dhënë që provon se ai ka të drejta reale mbi këtë objekt. Po ashtu, subjekti evidenton se Komisioni jo pa qëllim ka lënë jashtë vëmendjes faktin se subjekti në vitin 2023 ka blerë një apartament në pronësi të tij¹³, investim të cilin nuk do kishte nevojë ta kryente nëse do të kishte pjesë të banesa e vëllezërve, në kushtet kur ai jeton i vetëm.

18.9. Nga analizimi i të dhënave të rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit, trupi gjykues konstaton se:

- i) Me formularin “Vetëdeklarim për legalizim”, datë 14.11.2006, z. A. N.¹⁴ ka bërë kërkesë për legalizimin e objektit 2 kate, me adresë, {***} Korçë¹⁵, me sip. ndërtimi 145 m² me sipërfaqe të zënë 209 m², të deklaruar si e ndërtuar në vitin 2000.
- ii) Në praktikën e legalizimit është përfshirë certifikata familjare e z. A. N. e përbërë prej tij, bashkëshortes dhe djalit.
- iii) Sipas shkresës me nr. {***} prot., datë 23.04.2024, të dërguar nga FshU-ja drejt Komisionit, rezulton se për objektin e objekt kontrolli, në sistemin e faturimit të FShU-së,

*përkasin abonentëve N. (i cili ka ndryshuar emrin në A.) dhe F. N. Kontratat janë hapur në shtator të vitit 2005, me adresë “{***}”.*

*Për kontratën e dytë, e cila rezulton në emër të shtetasit F. N., me adresën Korçë, kabina “{***}”, sipas dokumentit mbi detajet e pagesës së konsumatorit F. N., rezulton se për këtë kontratë detyrimi i pashlyer për periudhën janar 2011 – prill 2024 është në shumën 85.056,40 lekë.*

¹³ *Ky apartament gjendet në lagjen “{***}”, në Korçë, në një objekt të privatizuar nga EKB-ja, me sip. 61 m², i cili është blerë nga subjekti i rivlerësimit me anë të kontratës së shitblerjes, me nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 30.10.2023, për çmimin 25.000 euro.*

¹⁴ *Sipas të dhënave të shkresës nr. {***} prot., datë 29.04.2024, të Zyrës së Gjendjes Civile të Bashkisë Korçë, A. E. N. i datëlindjes 14.01.1971, me ID {***}, më parë quhej N. N.*

¹⁵ *Adrese e cila më pas sipas të dhënave të verifikimit në terren të objektit nga përfaqësuesit e ALUIZNI-t referohet me emrin rruga “{***}”, lagja nr. {***}, Korçë.*

rezultojnë të lidhura dy kontrata për furnizimin me energji eklektike, përkatësisht me nr. {***}, që i përket abonentit N. N. dhe kontrata me nr. {***}, që i përket abonentit F. N.

- iv) Subjekti ka deklaruar gjatë hetimit administrativ se në këtë banesë ka banuar edhe nëna e tij, znj. B. N., e cila, sipas të dhënave të Regjistratit të Gjendjes Civile Korçë, ka figuruar në të njëjtën certifikatë familjare me vëllezërit e subjektit, F. N. dhe A. N. Subjekti, në përgjigjet e dhëna për pyetësonin nr. 3, datë 15.04.2024, ka deklaruar se: *Në kohën e blerjes së truallit vëllai A. ka qenë në të njëjtën familje me nënën, B. dhe dy vëllezërit, F. dhe A. N.. A. është me aftësi të kufizuara. A. ka blerë truallin, të formalizuar me kontratë, por trualli u përkiste të katërve.*

18.10. Nga sa përshkruar më lart, përveç vetëdeklarimit të subjektit se ai ka banuar për një periudhë 2-vjeçare në banesën e vëllezërve të tij, asnjë e dhënë tjetër e dalë nga hetimi nuk rezulton të lidhë subjektin me këtë pasuri. Përkundrazi, të dhënat e vetme që kanë rezultuar nga hetimi provojnë vetëm faktin se kjo banesë është ndërtuar prej vëllezërve që në vitin 2000, kur subjekti jetonte dhe punonte në Ersekë, është përdorur gjithmonë prej dy familjeve të tyre, madje edhe tabela fotografike e administruar nga ALUIZNI, pasqyron një banesë të konceptuar e ndërtuar për qëllime të banimit të vetëm dy familjeve, dhe këto dy familje janë ato të vëllezërve të subjektit, A. e F. N. Banimi i tyre në këtë pasuri, që do të thotë edhe ushtrimi i të drejtave të përdorimit të kësaj prone, janë ushtruar prej tyre, me cilësinë e pronarit, siç rezulton edhe nga kontratat për furnizimin me ujë lidhur me FShU-në, po në emër të këtyre dy shtetasve. Lejimi i banimit të subjektit për një periudhë kohe në këtë banesë, krahas nënës së tij, nuk mund të barazohet me gëzimin e së drejtës së përdorimit, e cila si rregull ushtrohet në mënyrë autonome dhe të mëvetësishme. Nga situata faktike e përshkruar më lart, duket se subjekti ka shfrytëzuar mundësinë e dhënë prej vëllezërve për strehim për një periudhë të shkurtër kohore, por kjo marrëdhënie, në vlerësimin e trupit gjykues, nuk krijon dyshime për një raport përtej atij të deklaruar nga subjekti lidhur me këtë pasuri. Në këto kushte, kontrolli i burimeve të krijimit të kësaj pasurie prej vëllezërve të subjektit nuk paraqet asnjë relevancë, për sa i përket qëndrimit që trupit gjykues lidhur me marrëdhënien e subjektit me këtë pasuri. Mënyra se si vëllezërit e subjektit kanë arritur të ndërtojnë banesën dhe burimet e përdorura për këtë qëllim, tejkalojnë, për shkak të rrethanave të rastit, qëllimin e procesit të rivlerësimit.

18.11. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues, pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me konkluzionin e Komisionit që i referohet deklarimeve rreth banesës së vëllezërve të tij të ndodhur në qytetin e Korçës, i gjeti ato të drejta, ndërsa qëndrimin e Komisionit të pambështetur në faktet e rezultuara prej hetimit. *Së pari*, evidentohet fakti se Komisioni ka bërë një vlerësim të paqartë lidhur me këtë çështje e në mungesë të një analize të rrethanave që e ka shtyrë atë drejt këtij konkluzioni. *Së dyti*, trupi gjykues, nga shqyrtimi i kujdesshëm i çdo të dhëne që rezulton nga hetimi, nuk konstatoi asnjë fakt që justifikon fillimisht, orientimin e Komisionit drejt hetimit për kontrollin e kësaj pasurie, dhe më pas as dhe ndonjë fakt që provon në ndonjë mënyrë të arsyeshme një lidhje të subjektit me këtë pasuri, e cila, për më tepër, të shkaktojë ndonjë përgjegjësi të tij lidhur me këtë pronë. *Së treti*, trupi gjykues e gjeti të pambështetur në thelb qëndrimin e Komisionit se subjekti ka bërë deklarime kontradiktore, të cilat kanë cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në konsideratë të disa rrethanave si në vijim, por jo vetëm: (i) subjekti nuk ka gëzuar të drejta përdorimi mbi këtë banesë, ai ka deklaruar se ka jetuar në të, për periudha të ndryshme brenda harkut kohor dyvjeçar, së bashku me pronarët e saj, por edhe me

nënën e tij e një vëlla tjetër të tij, rrethana që e zhveshin atë nga këto të drejta në kuptim të ligjit nr. 84/2016; (ii) banesa rezulton të jetë ndërtuar që në vitet 2000, prej vëllezërve të tij, të cilët edhe banojnë në të, kohë kur subjekti ushtronte funksionet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Ersekë, jashtë nevojës/ambicies apo indicieve për të krijuar një banesë në qytetin e Korçës; (iii) banesa rezulton të jetë banuar prej dy vëllezërve të subjektit dhe kontratat e shërbimeve utilitare e konfirmojnë këtë që prej vitit 2005; (iv) lëvizja e subjektit në banesa të tjera me qira deri ditën e nënshkrimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, por edhe më pas kur rezulton se subjekti ka blerë një banesë në pronësi të tij vetëm në vitin 2023, demonstroi mospasjen e asnjë interesi pasuror në këtë pronë prej tij; (v) analiza financiare e kryer nga Komisioni, për mundësitë e vëllezërve të tij për ndërtimin e kësaj banese, konstatohet se është krejt sipërfaqësore dhe jashtë çdo standardi ligjor dhe faktik të vendosur prej institucioneve të rivlerësimit dhe ,si e tillë, konsiderohet jo vetëm parelevancë në vlerësimin e çështjes, por edhe shumë larg realitetit të rrethanave në të cilat është krijuar; (vi) marrëdhëniet familjare të subjektit me të afërmit e tij duket se kanë diktuar jetesën e subjektit në këtë banesë për periudha kohore të shkëputura, jo vetëm për shkak të nevojës së subjektit për strehim, por edhe specifikave familjare të vetë atyre.

19. Pas reflektimit në analizën financiare të viteve 2003-2016, të kryer nga Komisioni, të konkluzioneve të mësipërme lidhur me automjetin dhe gjendjen *cash*, subjekti i rivlerësimit rezulton me një balancë financiare negative në total në vlerën prej (-) 602.619 lekësh, që i korrespondon analizës financiare të vitit 2004 dhe asaj për krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*.
20. Këtë balancë negative për të gjithë periudhën e rivlerësimit, trupi gjykues e vlerësoi nën dritën e parimeve të proporcionalitetit dhe objektivitetit, si të pamjaftueshme për të vendosur subjektin në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke konkluduar se subjekti ka rritur një nivel të besueshëm lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në përputhje me parashikimet e nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës

21. Trupi gjykues shqyrtoi pretendimet e subjektit lidhur me konkluzionet e Komisionit që janë përfshirë brenda kriterit të kontrollit të figurës, duke analizuar gjetjet e Komisionit në dy çështjet penale të marra në analizë prej tij në kontekstin e këtij kriteri, si edhe informacioneve të njohura drejtpërdrejtë prej trupit gjykues, në organin ligjzbatues, sipas vlerësimit në vijim.

21.1. Në këtë kontekst, trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit, me të cilat kundërshton vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi se: (i) në të nuk është analizuar dhe argumentuar, përse gjejnë trajtim në kriterin e kontrollit të figurës çështje që kanë të bëjnë me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale; (ii) është i paargumentuar dhe i pabazuar ligjërisht konkluzioni lidhur me çështjen penal nr. {***/2014, që lidhet me veprën penale “Prerja e paligjshme e pyjeve” parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal; (iii) është i pabazuar dhe i paargumentuar konkluzioni për shkeljet e pretenduara si të kryera nga subjekti në lidhje me çështjen e shtetasit G. Gj., për shkak se: (a) nuk ka qenë detyrë e tij funksionale ndarja e çështjeve nëpërmjet shortit elektronik dhe, për pasojë, nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për këtë veprimtari; (b) në trajtimin e bërë për çështjen penale-administrative të shtetasit G. Gj., Komisioni nuk ka konsideruar qëndrimin e subjektit para gjykatës *kundër* pranimin të

kërkesës së këtij të dënuari për “lirim me kusht”. Në funksion të shqyrtimit të këtyre pretendimeve, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson sa vijon.

21.2. Nga vendimi i Komisionit, rezulton se nisur nga informacionet e përcjella në Komision për subjektin Dashnor Nure, nëpërmjet raportit fillestar nr. {***} prot., datë 02.11.2017, rishikuar me nr. {***} prot., datë 02.07.2024, të deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {***}, datë 03.07.2024, të AKSIK-së, në të cilin *është konstatuar se bazuar në informacionin e ardhur nga institucionet verifikuese rezulton se disponohen të dhëna mbi përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e ndërveprimit korruptiv*, Komisioni ka verifikuar në vend të njëjtin informacion të aksesuar nga Grupi i Punës, si dhe burimet e informacionit. Mbështetur në informacionin e aksesuar drejtpërdrejtë në agjencitë ligjzbatuese, Komisioni ka administruar dosjet penale që lidheshin me këtë informacion, që duket se janë ato të renditua më lart, të cilat ia ka nënshtruar kontrollit dhe vlerësimit, duke konkluduar për to me gjetje që tregonin mangësi në aftësitë profesionale të subjektit. Këto problematika, Komisioni i ka konsideruar në kuadër të kriterit të kontrollit të figurës, duke arritur në konkluzionin se ato kanë konfirmuar informacionin e njohur drejtpërdrejtë në agjencinë ligjzbatuese. Në përfundim të këtij kontrolli, Komisioni ka konkluduar se *bazuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në vlerësim të raportit të figurës, rezultateve të hetimit lidhur me çështjet e referuara më lart, si dhe në kuadër të çmuarjes së shpjegimeve që ka dhënë edhe subjekti, krijoi bindjen se informacionet që disponoheshin në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Dashnor Nure, sipas kërkesave të shkronjave “b” dhe “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, ishin të bazuara në fakte dhe rrethana konkrete. Në këndvështrimin e përgjithshëm, edhe nëse ky konkluzion nuk do të ishte i mjaftueshëm për të arritur në një konkluzion lidhur me kontrollin e pastërtisë së figurës së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se mospërmbushja e rregullt e detyrës cenon pastërtinë e figurës së subjektit dhe shkallën e besueshmërisë së subjektit të rivlerësimit Dashnor Nure, në zbatim të pikës 2 të nenit 4 dhe pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

21.3. Për sa i përket pretendimit të subjektit se Komisioni padrejtësisht ka përfshirë brenda kriterit të kontrollit të figurës çështje dhe gjetje që lidhen me aftësitë e tij profesionale, trupi gjykues sjell në vëmendje se shtrirja e kësaj veprimtarie hetimore në këtë drejtim, mbështetur në informacionet e marra në agjencitë ligjzbatuese, përfaqëson tashmë një praktikë pune të konsoliduar të institucioneve të rivlerësimit, me synimin që nëpërmjet kontrollit të çështjeve, për të cilat kishte informacione në këto agjenci që nuk mund të ekspozoheshin për subjektet, të vlerësonin besueshmërinë dhe saktësinë e tyre, për të pasur si pasojë një panoramë të plotë të sjelljes së subjektit, në të cilën ndërthureshin elemente të integritetit dhe të aftësive profesionale. Në këtë kuptim, parimisht, trupi gjykues nuk gjen shkelje të dispozitave ligjore apo tejkalim të diskrecionit të Komisionit, në raport me metodologjinë e vlerësimit të informacioneve që vijnë nga agjencitë ligjzbatuese, në kuadër të kriterit të kontrollit të figurës.

21.4. Në vijim, trupi gjykues mori në analizë pretendimet e subjektit lidhur me dy çështjet penale në analizuara në kuadër të kriterit të kontrollit të figurës, për sa i përket drejtësisë dhe bazueshmërisë së vendimit të Komisionit, në prova e në ligj.

21.5. Lidhur me pretendimet e subjektit që i adresohen *konkluzioneve të Komisionit për çështjen penal nr. {***}/2014, të regjistruar për veprën penale “Prerja e paligjshme e pyjeve”* parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson sa vijon.

21.5.1. Nga vendimi i Komisionit lidhur me këtë çështje, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer verifikime në kuadër të materialit referues me nr. {***/2014, i cili është referuar për kryerjen e veprës penale “Prerja e paligjshme e pyjeve” parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal, duke vendosur për mosfillimin e ndjekjes penale, bazuar në nenin 38, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, me arsyetimin se në rastin konkret shkeljet e referuara si vepër penale duhen trajtuar sipas këtij neni, si kundërvajtje administrative. Pasi Komisioni ka analizuar veprimtarinë procedurale të subjektit në trajtimin e këtij materiali kallëzues, ka gjetur mangësi në zgjidhjen e rastit dhe arsyetimin e përdorur prej tij duke konkluduar se: *Duke mbajtur në konsideratë edhe rëndësinë e arsyetimit të vendimeve, si një garanci për procesin e rregullt ligjor, vlerëson se arsyetimi i dhënë në procedimin penal nga subjekti i rivlerësimit është në kushtet e mungesës së një argumentimi ligjor, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorin e parashikuar nga neni 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, pasi, nisur nga fakti që në kallëzim është kërkuar ndjekja penale, subjekti i rivlerësimit ka kanalizuar të dhënat e kallëzimit drejt procesit administrativ, dhe nuk ka konsideruar ekzistencën e fakteve penale ose nevojën për ndjekje penale.*

21.5.2. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionet e mësipërme të Komisionit, duke pretenduar se vendimi i mosfillimit është argumentuar në mënyrën në të mirë të mundshme, duke identifikuar qartë faktin e kallëzuar, provat ku mbështetet, si dhe duke saktësuar qartë dispozitat ligjore dhe nënligjore, si dhe bazën ligjore të vendimmarrjes së subjektit. Ai pretendon se arsyetimi i Komisionit është i përgjithshëm dhe joprofesional, i cili bie ndesh me konkluzionin e përgjithshëm të kriterit të vlerësimit profesional. Nga analizimi i akteve të administruara në fashikullin e Komisionit, lidhur me materialin referues nr. {***/2014, trupi gjykues konstaton se:

i) Më datë 26.08.2014, nga Oficeri i Policisë Gjyqësore, pranë Komisarariatit të Policisë Devoll, është hartuar akti “Informacion për referimin e veprës penale te prokurori”, me të cilin, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë bëhet me dije, si dhe i përcillen aktet e kapjes në flagrancë në aksin rrugor Bilisht-Arrëz, në fshatin Qytezë, të shtetasve I. C. dhe Xh. Xh., të cilët ishin duke transportuar me 4 (katër) kafshët e tyre dru zjarri të llojit ah, duke specifikuar se kishin dy kafshë samari të ngarkuar me dru secili, si dhe një motorrsekë (motorsharrë) me të cilën ishin prerë drutë. Në këtë referim informohet se këta shtetas kanë deklaruar se drutë i kanë prerë në mal mbi fshatin *Sinice* dhe se do i transportonin në shtëpitë e tyre për t’i përdorur për ngrohje në dimër. Oficeri i Policisë Gjyqësore pranë Komisarariatit Devoll, duke vlerësuar se me veprimet e kryera shtetasit I. C. dhe Xh. Xh. kanë konsumuar veprën penale “Prerja e paligjshme e pyjeve”, të parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal, e ka referuar atë si më sipër.

ii) Me marrjen e “Informacion për referimin e veprës penale te prokurori”, si dhe aktet që e shoqëronin atë, përkatësisht: *procesverbali i kapjes në flagrancë; procesverbali për këqyrjen e provave materiale* [masiv dru 1(një) m³]; *procesverbali për sekuestrimin e sendeve* (motorrsekë STIHL MS 300, dy kafshë mushka me samar dhe dy marrë dru ah me gjatësi 80-100 cm), subjekti i rivlerësimit ka kryer veprimet procedurale si vijon:

a) Më datë 27.08.2014, ka marrë vendim për “Vleftësimin e sekuestros” së provave materiale, dy barrë dru ah, dy kafshë samari, një motorrsekë për shtetasin Xh. Xh;

b) Më datë 27.08.2014, ka marrë vendim për “Vleftësimin e sekuestros” së provave materiale, dy marrë dru ah, dy kafshë samari, një motorrsekë për shtetasin I. C.;

c) Më datë 27.08.2014, ka nxjerrë “Urdhër për kryerjen e veprimeve verifikuese”, me të cilin i ka lënë detyrë Oficerit të Policisë Gjyqësore të verifikojë nëse shtetasit Xh. dhe C. janë të pajisur me leje për prerje, transport dhe shitje të lëndëve drusore; a ka pyje në fshatin Sinice, Devoll dhe nëse po, këto pyje janë pronë publike apo shtetërore; nëse ka pyje, a ndodhen ato në një zonë të mbrojtur sipas parashikimeve të VKM-së nr. 108, datë 27.01.2009 dhe ligjit nr. 8906, datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura; a kanë këto pyje statusin e përcaktimeve të VKM-së nr.108/2009; të kryhet akti i ekspertimit për të përcaktuar llojin e lëndës drusore, kohën e prerjes dhe vlerën e dëmit të shkaktuar, sipas tarifave të shpërblimit të dëmit.

iii) Në ekzekutim të urdhërimeve të mësipërme, me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 02.09.2014, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Pyjor të Qarkut Korçë, i bën me dije Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë se shtetasit Xh. Xh. dhe I. C. nuk janë të pajisur me leje për prerje pyjesh, tregtim dhe transport të lëndëve drusore. Po ashtu, me këtë shkresë, informohet se pyjet në fshatin Sinice, Devoll, kanë tre lloje pronësish, ato janë përkatësisht pyje shtetërore, pyje private dhe pyje komunale dhe se këto pyje nuk kanë statusin e “Zonës së Mbrojtur”, sipas VKM-së nr. 108, datë 27.01.2009, dhe se në këtë zonë nuk ka parcela eksperimentale, monumente, pyje mbrojtëse apo lloje të rralla të florës.

iv) Më datë 10.09.2014, z. Th. K., me profesion inxhinier pyjesh, me anë të aktit “Akt Ekspertizë, kryerje ekspertimi për lëndë drusore dhe lëndë zjarri”, përcakton se lënda drusore e sekuestruar shtetasve të mësipërm është e llojit dru ahu dhe se sasia e saj është 1m³ dhe kushton 30.000 lekë, që është edhe vlera e dëmit të shkaktuar.

21.5.3. Subjekti i rivlerësimit, pasi ka administruar dhe shqyrtuar të gjithë informacionin e siguruar nga verifikimi paraprak mbi materialin referues, më datë 22.09.2014, ka vendosur *mosfillimin e procedimit*. Në këtë vendim, subjekti, pasi përshkruan situatën faktike, e cila përputhet me përmbajtjen e *procesverbalit të kapjes në flagrancë* të shtetasve Xh. dhe C., evidenton se nga struktura përgjegjëse është bërë me dije se fshati Sinice, Devoll, ku janë prerë drurët, nuk është zonë e mbrojtur sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8906, datë 06.06.2002m “Për zonat e mbrojtura” dhe të VKM-së nr. 108, datë 27.01.2009, “Për kriteret e cilësimit të shkeljeve, me pasoja të rënda në pyje”, evidenton se sasia e druve të prerë është vetëm 1m³ dhe vlera e dëmit të shkaktuar është në masën prej 30.000 lekësh, arsyeton se fakti i referuar nuk përbën veprë penale, por kundërvajtje administrative, për shkak të vlerës së ulët të dëmit material të shkaktuar nga prerja pa leje e drurëve dhe, për pasojë, vendos të mosfillojë procedimin penal për këtë fakt. Gjithashtu, subjekti disponon edhe mbi sendet e sekuestruara nga Oficerët e Policisë Gjyqësore.

21.5.4. Në një vlerësim të përgjithshëm të kësaj situate, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit brenda afatit të përcaktuar prej udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 241, datë 21.11.2005, “Për regjistrimin e veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, i ndryshuar, në një periudhë kohe prej 25 ditësh ka kryer një veprimtari të plotë verifikuese, madje edhe përtej asaj që orientohet përgjithësisht nga praktika gjyqësore, për të arritur në konkluzionin se ndjekja penale në këtë rast nuk duhej të ushtrohej, mbështetur në nenin 291, pika 1, shkronja “ç” e Kodit të Procedurës Penale. Në këndvështrimin e arsyetimit të vendimit, trupi gjykues e gjen të pabazuar konkluzionin e Komisionit se ky arsyetim mungon, pasi siç u përshkrua më lart, vendimi i marrë në kontroll përmban të gjitha elementet e domosdoshme strukturore të një vendimi në pikëpamjen formale, por gjithashtu ai përmban një analizë të rrethanave të faktit në raport me kuadrin rregullator për administrimin e zonave

pyjore në vend, si dhe me kërkesat e nenit 205 të Kodit Penal, që përcaktojnë anën objektive të kësaj vepre penale. Në këtë prizëm, arsyetimi i vendimit është i plotë, logjik dhe i mbështetur në analizë të harmonizuar të rrethanave të faktit në raport me kuadrin ligjor të zbatueshëm.

21.5.5. Për sa i përket qëndrimit tjetër të Komisionit, sipas së cilit subjekti ka gabuar në zgjidhjen e çështjes, sepse fakti që për këtë ngjarje ka pasur kallëzim detyronte atë të regjistronte procedimin penal për të hetuar veprimtarinë kriminale të kryer dhe jo të trajtonte atë si kundërvajtje administrative, trupi gjykues vlerëson se ai është i gabuar e në shkelje të parimeve thelbësore kushtetuese që garantojnë të drejtën e organit të akuzës për ushtrimin e ndjekjes penale. *Së pari*, fakti që për këtë ngjarje ka pasur një referim nga struktura të policisë vendore të Devollit dhe jo prej strukturave të specializuara të policisë pyjore, ndonëse sërish do të vlente i njëjti arsyetim, nuk pengon/kufizon të drejtën e prokurorit të vlerësojë individualisht rastin në diskrecion të plotë të tagrave të tij kushtetuese për ushtrimin ose jo të ndjekjes penale. Parashikimi i nenit 38, pika 2 e ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”¹⁶, sipas së cilit policia pyjore bën kallëzim penal kur konstatohen pasoja të rënda nga prerja e pyjeve pa leje, nuk prodhon *ispo lege* detyrimin e organit të akuzës për të regjistruar procedimin penal mbi këtë kallëzim, por përcakton kompetencën e organit të specializuar për të njoftuar prokurorinë se ka ndodhur një vepre penale, por edhe në këtë rast, do të ishte sërish prokurori që do të duhej të vlerësonte nëse kallëzimi i paraqitur do të përmbushte apo jo kushtet për t’u regjistruar si procedim penal. Në rastin konkret, nuk ekziston asnjë prej rrethanave që Komisioni duket se ka vendosur në bazë të arsyetimit të tij për detyrueshmërinë e ushtrimit të ndjekjes penale, për pasojë ky qëndrim i tij është tërësisht i gabuar.

21.5.6. *Së dyti*, në drejtim të vlerësimit të mënyrës së zgjidhjes së çështjes, subjekti ka mirëarsyetuar se vlera prej 30.000 lekësh e konstatuar si dëm material, si ekuivalencë e prerjes së një sasive prej 1m³ lëndë drusore, konsiderohet si sasi e vogël, në kuptim të nenit 38, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”¹⁷ dhe të kriterëve që vendos VKM-ja nr. 108, datë 27.01.2009, “Për kriteret e cilësimit të shkeljeve, me pasoja të rënda në pyje”, për pasojë e ka konsideruar faktin si një kundërvajtje administrative dhe jo si vepër penale, duke analizuar në mënyrë të plotë elementet te të cilët bazohet vendimmarrja e tij. Sipas pikës 1 të VKM-së së cituar, përcaktohen rastet kur prerja e pyjeve ka shkaktuar pasojë të rëndë në kuptim të nenit 38 të ligjit nr. 9385/2005, ndërsa sipas pikës 2 të po këtij vendimi, çdo rast tjetër përbën pasojë të lehtë, si rrjedhojë jo një fakt penal, por një kundërvajtje administrative. Analiza e harmonizuar e këtyre parashikimeve ligjore në raport me rrethanat e rastit, me të drejtë e ka çuar subjektin në marrjen e vendimit për mosfillimin e procedimit penal.

21.5.7. Gjithashtu, në vlerësimin e këtij rasti, trupi gjykues konsideroi edhe informacionin e njohur drejtpërdrejtë në agjencinë ligjzbatuese lidhur me këtë çështje, nga i cili nuk u përftua asnjë e dhënë që të vendoste vlerësimin e mësipërm në një konkluzion të ndryshëm.

¹⁶ Kur shkeljet e këtij ligji kanë sjellë pasoja të rënda, Policia Pyjore bën kallëzim penal. Kriteret për ndarjen e shkeljeve me pasoja të lehta apo me pasoja të rënda caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

¹⁷ Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si me poshtë: a) prerja pa leje e pyjeve, e pyjeve të reja, e filizërisë dhe e fidanishteve, si dhe dëmtimi i tyre e i tokës pyjore, kur pasojat materiale janë të lehta, dënohet me gjobë 80 000 (tetëdhjetë mijë) deri në 100.000 (njëqind mijë) lekë;

21.5.8. Në përfundim, bazuar në sa analizuar më sipër, lidhur me çështjen penale nr. {***}/2014, të referuar për veprën penale “Prerje të paligjshme të pyjeve”, të parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal, atribuar shtetasve I. C. dhe Xh. Xh., trupi gjykues e gjeti të pambështetur në ligj konkluzionin e Komisionit se subjekti ishte i detyruar të ushtronte ndjekje penale për rastin, vetëm sepse policia kishte bërë kallëzim për faktin, duke e ngritur atë në nivelin e një vepre penale. Trupi gjykues vlerëson se rrethanat e rastit diktonin pikërisht trajtimin e tij si kundërvajtje administrative, ashtu siç subjekti i rivlerësimit ka vepruar, duke pasur në konsideratë se: (i) fakti i referuar si penal dhe i parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal, nga Shërbimet e Policisë së Shtetit, konsistonte në prerjen pa leje të drurëve pyjorë, në masën prej 1m³, me një vlerë dëmi prej 30.000 lekësh; (ii) neni 38, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, përcakton se: *“a) prerja pa leje e pyjeve, e pyjeve të reja, e filizërisë dhe e fidanishteve, si dhe dëmtimi i tyre e i tokës pyjore, kur pasojat materiale janë të lehta, dënohet me gjobë 80.000 (tetëdhjetë mijë) deri në 100.000 (njëqind mijë) lekë”*, ndërsa pika 2 e këtij neni përcakton se: *“Kur shkeljet e këtij ligji kanë sjellë pasoja të rënda, Policia Pyjore bën kallëzim penal. Kriteret për ndarjen e shkeljeve me pasoja të lehta apo me pasoja të rënda caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”*. Sipas VKM-së nr. 108, datë 27.01.2009, *“Për kriteret e cilësimit të shkeljeve, me pasoja të rënda”*, fondi pyjor i prekur dhe vlera e dëmit material të shkaktuar në rastin konkret nuk konsiderohen si pasojë e rëndë; (iii) pavarësisht se nuk ka një kallëzim penal nga policia pyjore siç ligji kërkon, si një vlerësim i specializuar nga organi kompetent, por ka një referim nga policia e shtetit për kryerjen e veprës penale, konkluzioni se vetëm për këtë shkak prokurori duhej të ushtronte ndjekjen penale është i pambështetur në ligj dhe cenon kompetencën kushtuese të organit të akuzës, për të ushtruar ndjekjen penale në zbatim të parimit të ligjshmërisë, i cili vlerësohet rast pas rasti prej prokurorit dhe jo organeve që referojnë të dhëna që dyshohet se përbëjnë fakte penale.

21.6. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, me të cilat konsideron si jo të drejtë dhe të pabazuar ligjërisht konkluzionin e Komisionit lidhur me dosjen penale-administrative që i përket të dënuarit G. Gj., trupi gjykues konstaton dhe vlerëson sa vijon.

21.6.1. Nga vendimi objekt shqyrtimi rezulton se edhe kjo dosje është analizuar prej Komisionit, për shkak të informacioneve të përcjella e më pas të njohura drejtpërdrejtë në agjencinë ligjzbatuese. Subjekti i rivlerësimit ka marrë pjesë me cilësinë e përfaqësuesit të prokurorisë në çështjen penale- administrative që ka pasur si kërkues të dënuarin G. Gj., i cili vuante dënimin me burgim të përjetshëm, me objekt “lirim para kohe me kusht”. Kjo kërkesë është gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila, në përfundim, ka vendosur pranimin e kërkesës së tij. Subjekti i rivlerësimit, në këtë proces, ka mbajtur qëndrim kundër pranimit të kësaj kërkesë, e cila nuk është konsideruar prej gjykatës që ka marrë vendimin. Komisioni ka konstatuar problematika në këtë rast, për sa i përket caktimit të kësaj çështje të subjekti i rivlerësimit, duke arsyetuar se kjo procedurë ngarkon atë me përgjegjësi meqenëse ai ka detyrim të zbatojë parashikimet ligjore edhe lidhur me mënyrën e ndarjes së çështjeve në prokurori. Në përfundim të procesit, Komisioni ka konkluduar se: *Shpjegimet e subjektit se udhëzimi nr. 3, datë 29.12.2016, i Prokurorit të Përgjithshëm “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori” dhe përgjegjësia e zbatimit të tij i takon vetëm drejtuesit të prokurorisë, nuk janë të bazuara në ligj. Përdorimi i sistemit të menaxhimit të çështjeve duhet të kryhet në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimit nr. 3, datë 29.12.2016, të Prokurorit*

të Përgjithshëm “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”. Zbatimi i parashikimeve ligjore sa më sipër është detyrë jo vetëm e drejtuesit, por edhe e prokurorit të çështjes, për të siguruar pavarësinë e tij referuar parashikimeve të bëra në nenin 6 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

21.6.2. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar këtë qëndrim të Komisionit duke pretenduar se: (i) nuk ka qenë detyrë e tij organizimi i shortit për ndarjen e çështjeve të regjistruara në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, pasi kjo detyrë, në zbatim të udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 03, datë 29.12.2016, “Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori”, i përkiste titullarit të kësaj prokurorie, i cili ishte përgjegjës për organizimin e shortit elektronik; dhe se (ii) në përfaqësimin në gjykatë të prokurorisë lidhur me shqyrtimin e kërkesës së të dënuarit G. Gj. për “*lirim me kusht*” për vuajtjen e pjesës së mbetur të dënimit, subjekti ka mbajtur qëndrimin se kjo kërkesë nuk është e drejtë dhe e bazuar ligjërisht, qëndrim i cili, sipas tij, rrëzon çdo pretendim për përfshirjen e subjektit në tentative për të ndihmuar të pandehurin.

21.6.3. Trupi gjykues, nga shqyrtimi i akteve të administruara nga hetimi administrativ, konstaton se:

i) me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 18.06.2024, Prokuroria pranë Gjykatë së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë i ka përcjellë Komisionit kopje të formularëve të shortit për shqyrtimin e kërkesave “Për lirim me kusht” në vitin 2017 dhe 2018, të cilat përmbajnë emrin e kërkesës së të dënuarit, si dhe prokurorin e caktuar për të përfaqësuar prokurorinë. Këto formularë konstatohet se janë të nënshkruar nga Drejtuesi i Prokurorisë, *sekretaria regjistruese* dhe *sekretaria e ekzekutimit*, dhe nga mënyra se si janë konceptuar, duket se caktimi i prokurorit, që do marrë pjesë në shqyrtimin e këtyre kërkesave, nuk është bërë nëpërmjet shortit elektronik;

ii) nga analizimi i përmbajtjes së udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 03, datë 29.12.2016, “Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori”, konstatohet se në dispozitat e fundit ngarkon për zbatimin e tij drejtuesit e prokurorive. Gjithashtu, në pikën 2 të udhëzimit, listohen çështjet të cilat përjashtohen nga hedhja e shortit elektronik, nga përmbajtja e të cilave mbetet e paqartë nëse çështjet që lidhen me shqyrtimin në gjykatë të kërkesave të të dënuarve për “*lirim me kusht*”, bëjnë pjesë të kjo kategori;

iii) në fashikullin e hetimit administrativ gjendet e administruar shkresa me nr. {***} prot., datë 23.05.2024, me të cilën Komisioni i kërkon informacion Prokurorisë pranë Gjykatë së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, *përse autorizimi i datës 14.09.2018, me të cilin është autorizuar të marrë pjesë subjekti i rivlerësimit Dashnor Nure, në gjykimin e çështjes se të pandehurit G. Gj., është bërë me short manual dhe jo elektronik dhe nuk ka numër protokolli;*

iv) në përgjigje të kësaj kërkesë, Prokuroria pranë Gjykatë së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me shkresën nr. {***} prot., datë 31.05.2024, informon se: (a) sistemi CAMS nuk lejon hedhjen në short të çështjeve që nuk marrin një numër kallëzimi, siç është rasti konkret për thirrjen në gjykim të prokurorit; (b) shkresa që autorizon prokurorin të marrë pjesë në seancë gjyqësore përmban datën e lëshimit, emrin e kërkuarit, objektin datën dhe orën e seancës gjyqësore, si edhe nënshkruhet e vuloset nga Drejtuesi, duke sqaruar se nuk është parë e nevojshme që ky autorizimi të marrë numër protokolli. Për të mbështetur këtë sqarim,

bashkëlidhur kësaj shkrese, janë depozituar fotokopje të disa autorizimeve të ngjashme të lëshuara në vitin 2018; (c) evidentohet se në gjykimin e kërkesës për *lirim me kusht* të të burgosurit G. Gj., *prokurori ka kërkuar rrëzimin e kërkesës së të dënuarit*. Pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur pranimin e kërkesës, prokurori ka ankimuar vendimin e kësaj gjykate dhe Gjykata e Apelit ka pranuar ankimin e prokurorit. Dosja është kontrolluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe nuk janë gjetur të meta në qëndrimin e prokurorit.

21.6.4. Mbështetur në të faktet e referuara më lart: (i) në kushtet kur udhëzimi i Prokurorit të Përgjithshëm nr. 03, datë 29.12.2016, në mënyrë të qartë përcakton drejtuesin e prokurorisë si përgjegjës për realizimin e shortit elektronik; dhe (ii) kur sipas shpjegimeve Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, mbi çështjet që nuk i nënshtrohet shortit elektronik me sistemin CAMS, si dhe modalitetet për caktimin e prokurorëve në çështjet që nuk mund të jenë objekt i shortit elektronik, trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit se ai nuk mund të luante rol në organizimin e shortit elektronik është i drejtë dhe i bazuar në prova. Nga e gjitha situata e mësipërme, rezulton se përgjegjësia për ndarjen e çështjeve, nëpërmjet shortit elektronik apo atij manual, i përket Drejtuesit të Prokurorisë. Për më tepër, në rastin e ndarjes së kësaj kategorie çështjesh, shpjegimi që jepet për ndarjen e tyre nëpërmjet shortit manual e jo elektronik gjendet bindës sa kohë që ky shpjegim vjen si një përgjigje e një komunikimi zyrtar mes Drejtuesit të Prokurorisë dhe Komisionit. Thirrja nën përgjegjësi e subjektit për një situatë të tillë do të tejkalohte ato veprime apo mosveprime që procesi i rivlerësimit ka pasur si synim të kontrollojë në drejtim të sjelljes funksionale të subjekteve të rivlerësimit, prandaj trupi gjykues e gjen të padrejtë qëndrimin e Komisionit lidhur me këtë çështje.

21.6.5. Konkluzionit të mësipërm i bashkohet edhe vlerësimi që i bëhet qëndrimit të ka mbajtur subjekti në raport me kërkesën objekt gjykimi, nëpërmjet kërkimit për rrëzimin e saj. Ky fakt nuk mbështet dyshimet e ngritura për shkak të njohjes me informacionin e aksesuar në agjencinë ligjzbatuese *mbi përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e ndërveprimit korruptiv*. Ky konkluzion, në vlerësimin e trupit gjykues, nuk është i cenueshëm as nga informacioni i njohur drejtpërdrejtë në agjencinë ligjzbatuese, sipas së cilit nuk rezultuan të dhëna të vlefshme në këtë drejtim.

21.6.6. Në përmbledhje të sa më sipër, lidhur me shqyrtimin në gjykatë të kërkesës për “Lirim me kusht” të të dënuarit G. Gj., trupi gjykues e gjeti të padrejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit duhej të përgjigjej për mënyrën e shpërndarjes së çështjeve në organin e prokurorisë, kompetenca që ligji nr. 97/2016 dhe aktet normative në zbatim të tij ia kanë ngarkuar titullarit të secilës zyrë prokurorie. Krahas këtij qëndrimi, trupi gjykues vlerëson se në rastin konkret duhet të sillen në vëmendje edhe disa rrethana që e bëjnë, gjithashtu, të padrejtë qëndrimin e Komisionit si: (i) qëndrimi i subjektit në raport me çështjen, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës së të dënuarit dhe ka apeluar vendimin e gjykatës që e ka pranuar atë, qëndrim, i cili logjikshëm nuk mbështet dyshimet e ngritura për ndërveprime korruptive të tij; (ii) nëpërmjet të dhënave të përcjella nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me shkresën nr. {***} prot., datë 31.05.2024, jepet një informacion i plotë për mënyrën e shpërndarjes së çështjeve me natyrë të tillë, duke përdorur për këtë qëllim shortin manual dhe jo elektronik, që në çdo rast nuk është përgjegjësi e subjektit, por që demonstroi pavarësisht se praktika nëpërmjet së cilës ai ka marrë çështjen në

dorëzim, nuk rezulton të jetë abuzive apo të krijojë dyshime të adresuara atij, në kuptim të cenimit të nenit 6 të ligjit nr. 97/2016.

21.6.7. Në përmbledhje, nga njohja e drejtpërdrejtë e informacionit të klasifikuar, trupi gjykues konstatoi se të dhënat që përfshihen në të nuk japin asnjë informacion të vlefshëm në drejtim të dhënies peshë të ndryshme të konkluzioneve të arritura në dy çështjet penale si më lartarsyetuar, lidhur me vlerësimin e sjelljes së subjektit në kuadër të kontrollit të kriterit të figurës. Për pasojë, konkluzioni i Komisionit se subjekti ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, lidhur me këto gjetje, gjendet i padrejtë dhe i paargumentuar.

21.7. Për sa më lart, trupi gjykues arriti në konkluzionin se asnjë përfundim negativ nuk mund të nxirret për sa i përket kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit, dhe se ai konsiderohet se ka arritur nivel të besueshëm lidhur me këtë kriter, sipas përcaktimit të nenit DH, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 59, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

- 22.** Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, me të cilat kundërshton si të pabazuara dhe jo të drejta konkluzionet e Komisionit, *lidhur me denoncimin e shtetases Xh. Q.¹⁸, që i referohet hetimit nga subjekti të procedimit penal nr. {***/2014, në ngarkim të shtetasit Gj. N., për veprën penale “mjekim i pakujdesshëm”, të parashikuar nga neni 96 i Kodit Penal, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson sa vijon.*

22.1. Nga të dhënat e fashikullit të hetimit administrativ, rezulton se Komisioni, pasi është njohur me denoncimin e shtetases Xh. Q. dhe ka administruar dosjen e procedimit penal nr. {***/2014¹⁹, i ka kaluar barrë prove subjektit për të dhënë shpjegime lidhur me sa duket se:

- i. Subjekti i rivlerësimit nuk ka vepruar në përputhje me nenin 24/1 të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet: “Prokurori ushtron ndjekjen penale [...], drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm [...]”;*
- ii. Subjekti nuk ka kryer veprime hetimore nga data 18.02.2015 deri më 18.05.2015. Vetëm në datën 12.05.2015, me shkresë të drejtuesit të prokurorisë, është kërkuar kryerja e ekspertimit mjekoligjor; nuk ka administruar deklaratat e ekspertëve, të cilat nuk rezultojnë në dosje.*

22.2. Subjekti, në prapësimet e tij, ka shpjeguar se: *“Për periudhën 18.02.2015 – 18.05.2015 nuk janë kryer veprime hetimore, pasi ka vlerësuar se ato ishin të plota, me përjashtim të administrimit të aktit të ekspertimit mjekoligjor, akt i cili ka ardhur dhe është administruar pas datës 18.05.2015, në datën 25.05.2015. Lidhur me mungesën e deklaratave të ekspertit, sqaroj se për aktet e ekspertimit që kryheshin nga Instituti i Mjekësisë Ligjore dhe Instituti i Policisë Shkencore, ato nuk shoqëroheshin me deklaratën e ekspertit, pasi në vendimin e ekspertimit nuk mund të caktohej emri i ekspertit, pasi nuk njihej dhe ai caktohej nga institucioni. Rrjedhimisht, deri vonë, këto akte janë pranuar nga të gjithë prokurorët edhe nga gjykatat të pashoqëruara me deklaratën e ekspertit. Kohën e fundit është kthyer në praktikë të konsoliduar*

¹⁸ Të administruar në Komision me nr. {***/} prot., datë 02.02.2018.

¹⁹ Ky procedim penal i është përcjellë Komisionit nga Prokuroria pranë Gjykatë së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me shkresën nr. {***/} prot., datë 27.02.2024.

që aktet e ekspertimit të kryer nga ekspertë të këtyre fushave shoqërohen edhe me deklaratën e ekspertit”.

22.3. Në përfundim të procesit, Komisioni, pasi ka shqyrtuar pretendimet e denoncueses, si dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti në përgjigje të barrës së provës, ka konkluduar se: *Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, sipas së cilave ai nuk ka vepruar në përputhje me nenin 24/1 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe mbi mungesën e kryerjes së veprime hetimore prej tij nga data 18.02.2015 deri më 18.05.2015. Komisioni, pasi administroi dhe vlerësoi shpjegimet e subjektit, mban qëndrimin se subjekti ka treguar mangësi në përmbushjen e rregullt e detyrës, duke cenuar shkallën e besueshmërisë së tij, në zbatim të pikës 2 të nenit 4 dhe pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

22.4. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ashtu si dhe në Komision, pretendon se konkluzioni i mësipërm i Komisionit është i gabuar, pasi: (i) në periudhën 18.02.2015 - 18.5.2015 nuk ka qenë e nevojshme të kryente veprime hetimore të tjera, pasi ishte vetëm në pritje të administrimit të aktit të riexpertimit mjekoligjor, i cili shpjegon se është depozituar më datë 25.05.2015; (ii) Komisioni nuk ka konsideruar se aktet e ekspertimit që kryheshin nga Instituti i Mjekësisë Ligjore nuk shoqëroheshin me deklaratën e ekspertit, pasi në vendimin e ekspertimit nuk mund të caktohej emri i tij për shkak se ai nuk njihej, pasi ai caktohej nga instituti, duke pretenduar se ekspertet e këtij institucioni ishin të gjithë të betuar për ushtrimin e rregullt të detyrës. Mosshoqërimi i akteve të ekspertimit me deklaratën e ekspertit, në këtë periudhë, nuk ka qenë një praktikë e ndjekur vetëm prej tij, por prej të gjithë kolegëve.

22.5. Trupi gjykues mori në analizë të dhënat e administruara në fashikullin e Komisionit lidhur me procedimin penal nr. {***/2014, në ngarkim të shtetasit Gj. N., regjistruar për veprën penale “Mjekim i pakujdesshëm” të parashikuar nga neni 96 i Kodit Penal, nga të cilat konstatoi sa vijon:

- i) Për shkak të konstatimit të humbjes së jetës së shtetasit M. Q., mbi bazën e kallëzimit të bërë nga Komisariati i Policisë Korçë, datë 27.03.2014, është regjistruar procedimi penal nr. {***/2014, për veprën penale “Mjekim i pakujdesshëm”, parashikuar nga neni 96 i Kodit Penal. Po ashtu, për këtë ngjarje, mbi kallëzimin e datës 24.07.2014, të paraqitur prej motrës së viktimës Xh. Q., është regjistruar procedimi penal nr. {***/2014, për të njëjtën veprë penale.
- ii) Më datë 26.07.2014, Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë ka marrë vendim për bashkimin e procedimit penal nr. {***/2014 dhe nr. {***/2014, në një të vetëm i regjistruar me nr. {***/ i vitit 2014, bazuar në përcaktimet e nenit 79/1, germa “a” dhe nenit 92/1, germa “a” e Kodit të Procedurës Penale. Në këtë akt, Drejtuesi i Prokurorisë ka përcaktuar se hetimet do të kryhen nga subjekti i rivlerësimit Dashnor Nure. Në fashikullin e këtij procedimi gjenden të gjitha aktet procedurale të hartuara në kuadër të tij.
- iii) Subjekti i rivlerësimit, më datë 07.08.2014, ka nxjerrë urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore nga ana e Oficerit të Policisë Gjyqësore, duke i ngarkuar detyra specifike si: marrja e të dhënave të gjendjes familjare të viktimës; pyetja e familjareve nëse viktima vuante nga ndonjë sëmundje; pyetja e personave me të cilët ishte i shoqëruar viktima në ditën e vdekjes, lidhur me rrethanat e vdekjes; marrja nga Spitali Rajonal Korçë e kartelave mjekësore të hapura për viktimën; administrimi me shkresë i aktit të ekspertimit mjekoligjor nr. {***/, datë 30.04.2014, i cili ndodhet pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore

në Tiranë; duke përcaktuar si afat të kryerjes së këtyre veprimeve hetimore datën 20.09.2014.

- iv) Nëpërmjet shkresës nr. {***} regj., datë 10.11.2014, e Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë, me të cilën i përcillet Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, akti i ekspertimit mjekoligjor nr. {***}, për shtetasin M. Q. Në aktin e ekspertimit mjekoligjor nr. {***} të hartuar nga ekspertët Dr. Z. I. dhe Dr. E. Sh., *si shkak i vdekjes së viktimës përcaktohet diagnostikimi jo i duhur i viktimës, e cila ka sjellë për pasojë dhe mjekimin jo të duhur për ta kuruar për pankreatit akut, duke u shprehur se jemi para elementeve të mjekimit të pakujdesshëm në fazën e mjekimit dhe të trajtimit mjekësor të formës së nënvleftësimit dhe të mosveprimit që kanë ndikuar në ardhjen e pasojës vdekjen e shtetasit M. Q.*
- v) Pas administrimit të aktit të mësipërm, më datë 18.11.2014, subjekti i rivlerësimit ka nxjerrë “Urdhër për regjistrimin e procedimit penal dhe të emrit të personit të cilit i atribuohet vepra penale”, si shtetasi Gj. N. me profesion mjek.
- vi) Oficeri i Policisë Gjyqësore i ngarkuar nga subjekti i rivlerësimit për kryerjen e hetimeve të procedimit penal nr. {***}/2014, me anë të aktit “Relacion mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve të procedimit penal nr. {***}/2016” të datës 25.11.2014, i sugjeron subjektit të rivlerësimit, që në bazë të nenit 327/1 të Kodit të Procedurës Penale, çështja të dërgohet në gjykatë për gjykim në ngarkim të shtetasit Gj. N. për veprën penale “Mjekim i pakujdesshëm” i parashikuar nga neni 96 i Kodit Penal.
- vii) Sipas procesverbalit të datës 15.12.2014, për pyetjen e personit ndaj të cilit zhvillohet hetimi, i dyshuari Gj. N. konteston rezultatin e aktit të ekspertimit nr. {***}, si dhe paraqet kërkesën e tij me shkrim për kryerjen e një akti ekspertimit të ri.
- viii) Më datë 23.12.2014, mbi bazën e kësaj kërkesë të personit nën hetim, subjekti i rivlerësimit ka nxjerrë vendimin “Për kryerjen e ekspertimit të ri mjekoligjor”, duke kërkuar t’i jepet përgjigje pyetjeve shtesë që synonin përcaktimin më të qartë të shkakut të vdekjes së viktimës Q., në raport me veprimtarinë e të dyshuarit N. Në këtë urdhër, subjekti ka urdhëruar kryerje të aktit të ekspertimit nga Instituti i Mjekësisë Ligjore nga së paku dy ekspertë të tjerë të këtij instituti, të cilët *në momentin e marrjes së këtij vendimit të plotësojnë deklaratën e ekspertit dhe do t’i bashkëngjitet këtij vendimi.*
- ix) Në kushtet kur akti i riekspertimit nuk ishte paraqitur ende, subjekti me vendimin e datës 18.02.2015 ka vendosur zgjatjen e afatit të hetimeve për tre muaj.
- x) Instituti i Mjekësisë Ligjore, me anë të shkresës nr. {***} prot., date 18.05.2015, i ka përcjellë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, aktin e ri të ekspertimit mjekoligjor nr. {***}, tek i cili është arritur në konkluzionin *se ka mangësi mjekësore, ka pasur ekzaminim të përciptë dhe nëse mjeku do të ishte thelluar në shenjat e shfaqura duhet të konsultohet me mjek kirurg pasi kjo patologji trajtohet në mënyrë kirurgjikale.*
- xi) Mbi bazën e këtyre rezultateve hetimore, subjekti, më datë 01.06.2015, ka hartuar kërkesën për gjykimin e çështjes penale nr. {***}/2014, e cila i është përcjellë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

22.6. Nga sa përshkruar më sipër, duket se konstatimi i Komisionit *se subjekti nuk është kujdesur të marrë deklaratat e eksperteve që kanë kryer aktin e ekspertimit mjekoligjor të cilët ishin pjesë e Institutit të Mjekësisë Ligjore*, ka marrë indicie nga përmbajta e vendimit të marrë nga subjekti më datë 23.12.2014 “Për kryerjen e ekspertimit të ri mjekoligjor”, tek i cili, ndër të tjera, ka përcaktuar detyrimin e ekspertëve për përpilimin e deklaratës për betimin e tyre. Në këto kushte, përtej pretendimit të subjektit se në atë periudhë ishte praktikë e punës që të mos

merrej deklaratë nga eksperti i mjekësisë ligjore, meqenëse ai ishte i “betuar” pranë këtij institucioni për kryerjen më së miri të detyrës duke zbatuar ligjin, duket se vetë subjekti nuk i ka qëndruar *besnik* kësaj qasje, përderisa në vendimin për kryerjen e riekspertimit ka caktuar një rregull të ndryshëm. Po ashtu, rezulton se subjekti, si në Komision ashtu edhe në ankim, nuk ka paraqitur ndonjë dokument ligjor për të provuar këtë pretendim. Për rrjedhojë, trupi gjykues konstaton se së paku subjekti nuk është konsistent në qëndrimin e mbajtur lidhur me këtë detyrim ligjor, duke abstraguuar nga një vlerësim i ngjashëm që bën trupi gjykues për detyrimin për *betim* të ekspertëve që janë të punësuar pranë institucioneve shtetërore që janë krijuar dhe funksionojnë për kryerjen e shërbimeve të ekspertizës, në kuadër të procedimeve penale. Në çdo rast, trupi gjykues vlerëson se subjekti duhej të kishte qartësuar qëndrimin dhe praktikën e tij në lidhje me këtë çështje, duke unifomizuar trajtimin e kësaj situate në çdo rast të hasur. Për rrjedhojë, mbështetur mbi këtë analizë, konsiderohet i drejtë konstatimi i Komisionit, lidhur me këtë çështje, por ai vlerësohet pa peshë në arritjen e një konkluzioni lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit.

22.7. Lidhur me qëndrimin e Komisionit se subjekti ka zgjatur pa arsye afatin e hetimeve dhe nuk e ka përdorur këtë periudhë për të kryer asnjë veprimtari hetimore, trupi gjykues konstaton se të gjitha veprimet hetimore lidhur me administrimin e dokumentacionit, pyetjen e personave që kishin dijeni mbi çështjen, si dhe kryerjen e ekspertimit mjekoligjor, kishin përfunduar që më datë 25.11.2014, kur Oficeri i Policisë Gjyqësore i ngarkuar me hetimin e çështjes kishte hartuar raportin mbi hetimet e kryera, me të cilin i sugjeronte subjektit gjykimin e çështjes. E vetmja arsye për të cilën subjekti kishte vendosur zgjatjen e afatit të hetimit ishte pranimi i kërkesës së personit ndaj të cilit zhvilloheshin hetimet për kryerjen e një akti të ri ekspertimi mjekoligjor mbështetur edhe në pretendimet e pyetjet e tij. Siç rezulton nga aktet, subjekti ka vendosur të kryejë riekspertim me vendimin e datës 23.12.2014, ndërsa afati hetimor përfundonte në datën 18.02.2015. Në këto kushte, subjekti ka qenë i detyruar të zgjasë afatin hetimor në pritje të aktit të ri të ekspertimit, i cili është depozituar në prokurori me aktin me nr. {***} regj dhe mban datën 18.05.2015. Pas administrimit të këtij akti, subjekti nuk rezulton të ketë kryer asnjë veprimtari tjetër hetimore, përveç përgatitjes së akteve që nevojiten për dërgimin e çështjes në gjyq. Në këtë këndvështrim, trupi gjykues e gjen të pabazuar qëndrimin e Komisionit lidhur me këtë çështje. Subjekti i rivlerësimit duket se ka përdorur në mënyrë të arsyeshme dhe efikase mekanizmat ligjorë për të garantuar të drejtat e palëve në proces e ligjshmërinë e veprimtarisë hetimore gjithashtu. Për pasojë, pretendimet e tij, si më sipërcituar, gjenden të drejta.

22.8. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues, pasi analizoi veprimet hetimore të kryera prej subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë çështjen penale, konstatoi se periudha 18.02.2015 - 18.05.2015, e mbetur pa veprime hetimore prej tij, është diktuar nga pritja e kryerjes së një akti të ri ekspertimi mjekoligjor për përcaktimin e përgjegjësisë së të dyshuarit për kryerjen e veprës penale për të cilën hetohej. Pretendimi i subjektit se gjatë kësaj kohe nuk ka kryer veprime hetimore të tjera, sepse ishin kryer të gjitha ato që ishin konsideruar të nevojshme prej tij, gjendet i drejtë prej trupit gjykues. Rezulton se subjekti i rivlerësimit ka drejtuar hetimin dhe ka kryer një veprimtari hetimore të plotë, ndërsa nevoja për riekspertim është diktuar nga kërkesa e personit ndaj të cilit zhvilloheshin hetimet. Pritja e një periudhe tremujore, për përgjigjen nga ekspertët e caktuar për kryerjen e aktit të ekspertimit, edhe nëse do të konsiderohej se mund të menaxhohej në mënyrë më *proaktive*, sërish nuk vlerësohet se

përmban elementë që mund të ngrihen në nivelin e një shkeljeje që cenon besimin e publikut, ashtu si Komisioni ka konkluduar.

22.9. Analiza e mësipërme vlerësohet se duhet të konsiderohet e përfshirë në kuadër të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, për sa kohë trajton tipikisht elementë që lidhen me këtë kriter. Në këtë kuptim, trupi gjykues, duke mbajtur në konsideratë këtë analizë, krahas konkluzionit të Komisionit për këtë kriter, konkludon se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues lidhur me të, sipas parashikimit të nenit E, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1, shkronja “c” të ligjit nr. 84/2016.

23. Në përfundim, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me një nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, në kriterin e kontrollit të figurës dhe ka arritur një nivel kualifikues në kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, trupi gjykues vlerësoi se ai duhet të confirmohet në detyrë në zbatim të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, vendimi i Komisionit objekt shqyrtimi, që ka vendosur për shkarkimin e tij nga detyra, gjendet i pambështetur në prova dhe në ligj dhe, si tillë, duhet të ndryshohet.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 793, datë 04.09.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Dashnor Nure.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 09.12.2025

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi